www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2018 – Numri: 159

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 12 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148 (13), datë 4.4.2018

Me akuzë: Për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22, të Kodit Penal;
Për kryerjen e veprës penale "Moskallëzim i krimit", sipas nenit 300 të Kodit Penal..... 10429

VENDIM
Nr. 00-2018-148 (13), datë 4.4.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:
Xhezair Zaganjori kryesues;
Edmond Islamaj anëtar;
Shkëlzen Selimi anëtar;
Artan Zeneli anëtar;
Tom Ndreca anëtar,
në seancën gjyqësore të datës 4.4.2018, mori në shqyrtim çështjen penale me palë:

KËRKUES: Prokuroria për Krimet e Rënda, Tiranë

TË PANDEHUR: Ervin Pëllumbi, Albert Doku

AKUZA: Për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22, të Kodit Penal.

TË PANDEHUR: Gani Bushati, Bledar Osja

AKUZA: Për kryerjen e veprës penale "Moskallëzim i krimit", sipas nenit 300 të Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 90, datë 12.10.2017, ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ervin Pëllumbi për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve", në bashkëpunim, mbetur në tentativë, sipas neneve 283/a, paragrafi 2, dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe, përfundimisht, dënohet me 8 (tetë) vjet burgim.

- Vuajtja e dënimit fillon nga dita e arrestimit në flagrancë dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Albert Doku për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", në bashkëpunim, mbetur në tentativë, sipas neneve 283/a paragrafi 2, dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 14 (katërmbëdhjetë) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe, përfundimisht, dënohet me 9 (nëntë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

- Vuajtja e dënimit fillon nga dita e arrestimit në flagrancë dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gani Bushati për veprën penale të "Moskallëzim krimi", sipas nenit 300/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe, përfundimisht, dënohet me 2 (dy) vjet burgim.

- Vuajtja e dënimit fillon nga dita e arrestimit në flagrancë dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

4. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit Bledar Osja për veprën penale të "Moskallëzim krimi", sipas nenit 300 të Kodit Penal, bazuar në nenin 388, pika 1, germa "d", e Kodit të Procedurës Penale, për arsye se nuk provohet se i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

5. Provat materiale (sipas urdhrit për bashkimin e provës materiale me çështjen datë 14.10.2016) si më poshtë:

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 105, datë 19.12.2017, ka vendosur:

"- Konstatimin e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

- Prish vendimin nr. 90, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe urdhëron dërgimin e kësaj çështjeje në Gjykatën kompetente të Rrethit Gjyqësor Durrës."

I. Kundër vendimit të mësipërm, në datën 5.1.2018, ka paraqitur *rekurs* prokurori pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me anën e të cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po këtë gjykatë.*

Duke parashtruar si shkaqe përkatësisht:

- Në të kundërt, me sa arsyeton në vendim, Gjykata e Apelit për Krimet e Renda, mendojmë se bazuar në përcaktimet e dispozitës kalimtare, konkretisht të nenit 285 të ligjit 35/2017, gjykatat për krimet e rënda, vazhdojnë të kenë në kompetencën e tyre të gjykimit çështjet penale që kanë pasur në gjykim, para ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale, pra edhe veprën penale të "*Trafikimit të lëndës narkotike*" të parashikuar nga neni 283/a të KP-së.

- Këtë mendim e mbështesim në faktin se në pikën 1, të nenit 285, të ligjit të sipërpërmendur,

shprehet detyrimi për t'u gjykuar nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, sipas kompetencës lëndore të nenit 75/a të KPP-së, të ndryshuar, të çështjeve deri në krijimin e Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Mendojmë se ligjvënësi ka përfshirë në këtë formulim gjykatat e rretheve gjyqësore, bazuar në faktin se sipas nenit 75/a para ndryshimeve, këto gjykata kanë në kompetencë gjykimin e disa rasteve të korrupsionit (përjashtuar ato të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe të Gjykatës së Lartë për shkak të juridiksionit fillestar) dhe që me ndryshimet e bëra do të jenë në kompetencën e gjykimit të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

- Pra Gjykata e Krimeve të Rënda do të vazhdojë të gjykojë çështjet që ka pasur në kompetencë, sipas nenit 75/a të KPP-së, përpara ndryshimeve dhe po ashtu gjykatat e rretheve gjyqësore do të vazhdojnë të gjykojnë çështjet e korrupsionit për ato subjekte që i kanë pasur në kompetencë para ndryshimeve, deri në momentin e krijimit të Gjykatës Kundër Korrupsionit.

- Kjo frymë e ligjit jepet edhe me qartë në parashikimin e pikës 4, të nenit 285, të ligjit 35/2017, në të cilin përcaktohet detyrimi që Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda dhe të prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore do të vazhdojnë të hetojnë veprat penale ose subjektet e parashikuara në nenin 75/a të KPP-së, deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, *sipas kompetencës së përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

- Përderisa prokuroritë përkatëse kanë detyrimin të hetojnë veprat penale, siç i kanë pasur në kompetencë para ndryshimeve të KPP-së, nuk mund të mendohet që gjykatat, pranë të cilave kryejnë funksionet këto prokurori, të kenë kompetenca të ndryshme nga prokuroritë.

- Po t'i qëndrojmë linjës logjike të arsyetimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda për rastin në gjykim, atëherë veprat penale të trafikimeve do të hetoheshin nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, por do të gjykoheshin më pas nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës territoriale të tyre, gjë që do të krijonte një konfuzion të plotë në funksionimin e të gjithë sistemit dhe që pa dyshim nuk mund të ketë qenë në logjikën e ligjvënësit, i cili nëpërmjet dispozitës kalimtare garanton pikërisht vijimësinë normale të funksioneve deri në krijimin e Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

- Referuar rëndësisë së këtij problemi, e lidhur kjo dhe me faktin se, që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve procedurale e në vazhdimësi, gjykatat për krimet e rënda, në të dyja shkallët, kanë gjykuar dhe vijojnë të gjykojnë çështjet penale sipas kompetencës lëndore që kanë pasur, kemi mendimin se Kolegji Penal duhet ta kalojë këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për ndryshimin e praktikës gjyqësore, bazuar edhe në faktin se në vendimin nr. 130, datë 1.11.2017, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (rast të cilit i referohet në vendim edhe gjykata e apelit) ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe kalimin e akteve për t'u gjykuar nga Gjykata e Apelit Durrës.

II. I pandehuri Albert Doku, nëpërmjet mbrojtësit të tij, bazuar në nenin 423/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka kundërshtuar rekursin e mësipërm, duke parashtruar (ndër të tjera) se:

- Me ligjin nr. 35/2017, rezulton se nuk ka gjykatë dhe prokurori për krime të rënda, të cilat vazhdojnë të funksionojnë vetëm bazuar në dispozitën kalimtare, nenin 285 të këtij ligji.

- Kjo dispozitë është shumë e qartë dhe në unitet të plotë në të gjithën e saj, ka përcaktuar se kohëzgjatja e Gjykatës dhe e Prokurorisë për Krime të Rënda do të jetë deri në krijimin e Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

- Përveç kohëzgjatjes, kjo dispozitë ka përcaktuar edhe objektin e veprimtarisë së Gjykatës për Krime të Rënda, për të gjykuar disa nga çështjet që janë në kompetencë të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas parashikimeve të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

- Bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, në vlerësimin tim Gjykata për Krime të Rënda, sipas pikës 1, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, do të gjykojë vetëm ato çështje që janë parashikuar në nenin 75/a në kompetencë të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe njëkohësisht kanë qenë në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda para datës 1 gusht 2017. Veprat e tjera në kompetencë

të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas nenit 75/a, do të gjykohen nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

- Gjykata për Krimet e Rënda nuk është kompetente për gjykimin e veprës penale të "*Trafikimit të narkotikëve*", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, ndaj Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur drejtë në vendimin nr. 105, datë 10.12.2017, duke e dërguar këtë çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

- Gjithashtu, vlerësoj se bazuar në nenet e ndryshuara 14/a, 438/4 të Kodit të Procedurës Penale, praktika lidhur me kompetencën e çështjeve penale me objekt "*Trafikimi i narkotikëve*", tashmë është njësuar me vendimin nr. 130, datë 1.11.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, nuk ka më nevojë për ndryshimin e kësaj praktike gjyqësore.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Edmond Islamaj; prokurorin Adnand Xholi dhe Artur Selmani, të cilët kërkuan prishjen e vendimit nr. 105, datë 19.12., të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe kthimin e akteve për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes; pasi vendosi vazhdimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit për shkak se njoftimet ishin kryer sipas ligjit dhe nuk kishte shkak të justifikuar që të përligjte mungesë; pasi dëgjoi avokatin e të gjykuarit, Mirash Martini, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 105, datë 19.12.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; si dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjet

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se procedimi *de quo* është iniciuar nga kërkesa për gjykim e Prokurorisë pranë Gjykatës së krimeve të Rënda të Shkallës së Parë, e paraqitur në datën **18.10.2016**, që do të thotë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, përkundrejt të pandehurve z. *Ervin Pëllumbi, z. Albert Doku,* nën akuzën se kanë kryer faktin penalisht të ndëshkueshëm të "*Trafikimit të narkotikëve*", në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, vepër penale e parashikuar nga neni 283/a paragrafi i dytë dhe 22 i Kodit Penal, si dhe z. Gani Bushati dhe z. Bledar Osja, nën akuzën se kanë kryer veprën penale "Moskallëzim krimi", e parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

2. **Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 90, datë 12.10.2017**, ka vendosur mbi themelin e çështjes, duke i gjetur fajtorë të pandehurit dhe të dënuarit, sipas dispozitivit pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

3. Pas ankimit, çështja ka shkuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka ngritur kryesisht çështjen e kompetencës lëndore, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për gjykimin e çështjes penale, për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale (sipas ligjit nr. 35/2017), në lidhje me kompetencën lëndore për gjykimin e veprës penale të *"Trafikimit të narkotikëve*", të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22, të Kodit Penal.

4. **Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 105, datë 19.12.2017**, ka vendosur: *"- Konstatimin e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda. - Prish vendimin nr. 90, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe urdhëron dërgimin e kësaj çështjeje në gjykatën kompetente të Rrethit Gjyqësor Durrës.*".

5. Gjykata e Apelit për krimet e Rënda ka arsyetuar në vendim, se: *"... Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, kryesisht ngriti* çështjen *e kompetencës lëndore, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për gjykimin e çështjes penale, për shkak të ndërhyrjes së ndryshimeve në K. Pr. Penale në lidhje me kompetencën lëndore për gjykimin e veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal, vepër penale e cila pas reformimit të procedurës penale me ligjin nr. 35/2017, është vendosur në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, duke konkluduar, se: vendimi nr. 90, datë 12.10.2017, i Gjykatës për Krime të Rënda, është shpallur nga një Gjykatë që nuk ka pasur kompetencë lëndore, ndaj vendimi i apeluar duhet të prishet dhe çështja të dërgohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, si gjykata kompetente në lëndë dhe territor për të gjykuar veprën penale të parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë, dhe 22 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet se kanë kryer të pandehurit Ervin Pëllumbi dhe Albert Doku, si dhe veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për të cilën akuzohen se kanë kryer të pandehurit Gani Bushati dhe Bledar Osja, meqenëse*

ndodhemi përpara një procedimi të lidhur ... ligjvënësi ka ndërhyrë me ligjin nr. 35/2017, hyrë në fuqi më 1 gusht 2017, në reformim të ligjit procedural penal në dispozitat që parashikojnë mbi "Kompetencat", duke përcaktuar shprehimisht, në nenin 74 të K. Pr. Penale, se: "Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar". Ndërsa, në nenin 75/a të K. Pr. Penale, ... ligjvënësi ka listuar si veprat penale ashtu edhe subjektet në gjykimin lëndor të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Meqenëse, në këtë dispozitë qartazi lexohet se bëhet fjalë për Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çmohet e nevojshme të vihet në vëmendje, se pika 3, e nenit 14, të K. Pr. Penale, ka lidhje organike me pikën 1 dhe 6, të nenit 525 të K. Dr. Penale, ku nëpërmjet përdorimit të dispozitës tranzitore/kalimtare, ka shprehur qartësisht vullnetin e tij ligjvënësi, duke parashikuar vazhdimësinë e gjykatave për krimet e rënda (dy shkallët), kur vendos, se: "1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore", dispozitë e cila ka marrë fuqinë dhe si e tillë, detyrimisht për t'u zbatuar që nga data 1 gusht 2017...

Dhe, meqenëse të pandehurit që akuzohen se kanë kryer veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, që është më e rëndë se vepra penale e moskallëzimit të krimit, janë kapur në PKK Porti Durrës, teksa tentonin të eksportonin lëndën narkotike nga Shqipëria në Itali, kompetenca territoriale është ajo e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas parashikimit të nenit 76, pika 1, kombinuar me nenin 82 pika 1, të K. Pr. Penale.

Konkluzioni i këtij Kolegji, përveç arsyeve të ekspozuara në paragrafët e mësipërm, bazohet edhe në jurisprudencë njësuese të Gjykatës së Lartë, që për shkak të ligjit është e detyrueshme për t'u zbatuar. Kështu, së fundmi Kolegji i Gjykatës së Lartë, në lidhje me kompetencën lëndore, me vendimin nr. 130, datë 1.11.2017, kur ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë nr. 26, datë 16.3.2016, aktet i ka kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës, në njësim të praktikës gjyqësore ...".

6. Kundër vendimit të mësipërm, ka paraqitur rekurs Prokurori pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe ka paraqitur kundërshtimet e tij edhe avokati mbrojtës i të pandehurit, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

7. Prokurori ka pretenduar se, referuar rëndësisë së këtij problemi, e lidhur kjo dhe me faktin se që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve procedurale e në vazhdimësi, gjykatat për krimet e rënda në të dyja shkallët, kanë gjykuar dhe vijojnë të gjykojnë çështjet penale, sipas kompetencës lëndore që kanë pasur, kemi mendimin se Kolegji Penal duhet ta kalojë këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për ndryshimin e praktikës gjyqësore.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji"), pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të gjykimit, pretendimeve të palëve dhe analizës së kuadrit ligjor dhe të praktikës gjyqësore të gjykatave të faktit dhe vetë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkludon se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda është marrë në shkelje të ligjit procedural që atribuon kompetencën lëndore të gjykatës dhe, për rrjedhojë, duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë dhe para të njëjtit trup gjykues. Njëkohësisht, Kolegji vlerëson se vendimi për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi duhet të shërbejë për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me disa çështje, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e problematikës së rekursit objekt gjykimi dhe problematikave të tjera të lidhura apo të rrjedhura prej tyre.

i) Lidhur me çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore

9. Kolegji konstaton, se pas amendimeve të Kushtetutës[1], me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 95/2016, "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*" (në vijim "ligji nr. 95/2016") dhe me hyrjen në fuqi të amendimeve të Kodit të Procedurës Penale[2], në praktikën gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit dhe tri shkallëve të ndjekjes

[1] Shiko ligjin nr. 76/2016, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë',* të ndryshuar" (në vijim "ligji nr. 76/2016").

[2] Shiko ligjin nr. 35/2017, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar*" (në vijim "ligji nr. 35/2017").

penale janë krijuar disa problematika lidhur me kompetencën lëndore për hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, gjykimin dhe kthimin për rigjykim të çështjeve penale sipas llojit të veprës penale objekt procedimi. Duke qenë se ka pasur qëndrime të ndryshme të mbajtura nga praktika gjyqësore e gjykatave për krimet e rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore dhe, nga ana tjetër, duke qenë se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme, vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme që të njësohet praktika gjyqësore lidhur me disa çështje të cilat do të individualizohen më poshtë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vlerësuar se të gjitha këto çështje që kanë shqetësuar praktikën gjyqësore duhet të gjejnë një zgjidhje përfundimtare dhe të njësuar jurisprudenciale dhe, për këtë qëllim, është kaluar gjykimi i çështjes në seancë gjyqësore.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se dispozita kalimtare e Kodit të Procedurës Penale nuk është e qartë, është kontradiktore dhe e paplotë. Kjo mangësi në mënyrën e formulimit të saj ka lënë vend për interpretime të ndryshme nga praktika gjyqësore e tri shkallëve të gjykimit. Jo vetëm kaq, por Kolegji vlerëson se legjislatori ka ndryshuar disa herë qëndrim mbi atribuimin e kompetencës lëndore penale gjatë fazës tranzitore nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të vitit 2016 të Kushtetutës, te ligji nr. 95/2016, te ligji nr. 70/2017 dhe deri te ligji nr. 35/2017. Rregullimet jouniforme të ligjit për mënyrën se si do të ushtrohet juridiksioni penal i prokurorisë dhe i gjykatave, deri në krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë penale ka shkaktuar pasiguri dhe mungesë koherence në mënyrën se si prokuroritë dhe gjykatat kanë interpretuar dhe kanë zbatuar ligjin. Kjo mungesë koherence në hartimin e dispozitave tranzitore fillon me kontrastin e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, me nenin 57 të ligjit nr. 95/2016 dhe përfundon me kontrastin e rregullimit të pikës 1, me pikën 4, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017 dhe me pamjaftueshmërinë e rregullimit tranzitor normativ.

Boshësia e parë që ka kjo dispozitë tranzitore ka të bëjë me mungesën e një paragrafi që të rregullojë kompetencën lëndore të gjykatës që gjykon të gjitha çështjet, që nuk hyjnë më në vëllimin e nenit 75/a të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale, kërkesat për gjykim e të cilave janë paraqitur para datës 1 gusht 2018. Pikërisht kjo është çështja që është shtruar për gjykim dhe për zgjidhje para Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda në këtë gjykim dhe që për rrjedhojë Kolegji Penal në gjykimin e rekursit të prokurorisë ka vendosur të njësojë praktikën gjyqësore. E njëjta çështje shtrohet edhe për ndjekjen penale gjatë fazës së hetimit dhe të gjykimit nga prokuroritë pranë gjykatave për krimet e rënda.

Boshësia tjetër e dispozitës tranzitore të Kodit të Procedurës Penale ka të bëjë me çështjen, se në kompetencën e cilës prokurori është ushtrimi i ndjekjes penale për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale dhe të papërfshira në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Më tej, do të duhet, që për efekte të njësimit të praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të përcaktojë se në kompetencën e cilës gjykatë është gjykimi i këtyre veprave penale. Së fundmi, sërish për efektet e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të njësojë qëndrimin se cila prokurori dhe cila gjykatë ka në kompetencën lëndore ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykimin për veprat penale, të cilat neni 135, pika 2, i Kushtetutës, neni 8 dhe 9 i ligjit nr. 95/2016 dhe neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, fut rishtazi në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme, duke ndryshuar me parashikimet e nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Në të njëjtën kohë duhet të sqarohet mungesa e një paragrafi në parashikimet e dispozitës tranzitore për të rregulluar hyrjen në fuqi të nenit 74, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, në mënyrë të nënkuptuar pas ndryshimeve kushtetuese në nenin 141. Pas përgjigjeve njësuese mbi praktikën gjyqësore do të rrjedhë natyrshëm edhe konkluzioni se çfarë duhet të vendosë Gjykata e Lartë në rastin kur prish një vendim të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, duke konkluduar se ku kthehet çështja për rigjykim. Më tej, në të njëjtën mënyrë do të veprohet për disponime të kësaj natyre edhe nga Kolegji Penal apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nga gjykatat e apelit, gjithashtu, në ushtrim të funksionit të tyre rishikues, deri sa të konstituohen

gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar[3] (në vijim "GJKKKO").

Për rrjedhojë çështjet për të cilat Kolegji Penal ka vendosur të shtrojë për të njësuar praktikën gjyqësore nëpërmjet këtij vendimi janë:

a) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale për të cilat procedimi penal ka nisur para datës 1.8.2017 ndërmjet prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të posaçëm penal? Pra, cila prokurori do të ushtrojë ndjekjen penale dhe do të përfaqësojë akuzën në gjyq për veprat penale, procedimi penal i të cilave ka nisur para datës 1.8.2017?

b) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe e gjykatave me juridiksion posaçëm penal për kërkesat dhe çështjet e regjistruara për gjykim para datës 1.8.2017 dhe vazhdojnë të gjykohen pas kësaj date? Pra, cila gjykatë do të gjykojë çështjet që rrjedhin nga veprat penale, procedimi penal i të cilave ka nisur para datës 1.8.2017?

c) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore ndërmjet prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm penal për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale për të cilat procedimi penal ka nisur pas datës 1.8.2017 deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme? Pra, cila prokurori do të ushtrojë ndjekjen penale dhe do të përfaqësojë akuzën në gjyq për veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur pas datës 1.8.2017?

ç) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore ndërmjet gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm penal për kërkesat dhe çështjet që janë regjistruar dhe regjistrohen për gjykim pas datës 1.8.2017 deri në momentin kur të krijohet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar? Pra, cila gjykatë do të gjykojë çështjet që rrjedhin nga veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur dhe do të nisë pas datës 1.8.2017?

d) Kur gjykatat e apelit apo Gjykata e Lartë vendosin prishjen e vendimit, objekt ankimi, dhe kthejnë çështjen për rigjykim, cila do të jetë gjykata që do të rigjykojë çështjen nga pikëpamja e kompetencës lëndore, nga data 1.8.2017 e deri në momentin kur të krijohet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar?

ii) Lidhur me kompetencën e Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore

11. Kolegji Penal në dhomë këshillimi ka vendosur kalimin për gjykim të rekursit në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore për çështjet e lartrenditura. Kolegji Penal e ka bazuar këtë vendim në konsideratat e shprehura më lart dhe në nenin 432, pika 1, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, dispozitë e cila parashikon se rekursi mundet të paraqitet dhe duhet të gjykohet nga Gjykata e Lartë, kur çështja paraqet rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 14/a të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji u kompozua në seancë gjyqësore me pesë gjyqtarë, me qëllimin e gjykimit të çështjes dhe njësimin e praktikës gjyqësore.

Kolegji Penal vlerësoi se njësimi i praktikës gjyqësore lidhur me ushtrimin e juridiksionit penal pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2016 të Kushtetutës e deri në momentin e krijimit të institucioneve të reja të drejtësisë penale është i domosdoshëm për respektimin e standardeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe për miradministrimin e drejtësisë penale. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë është në rolin dhe autoritetin e saj kushtetues për të garantuar zhvillimin e së drejtës gjyqësore, garantimin e koherencës së zbatimit uniform të ligjit në Republikën e Shqipërisë dhe të përditësimit të nomofilatisë, në funksion të garantimit të parimit kushtetues të sigurisë juridike (shiko nenin 4 dhe 141 të Kushtetutës).

12. Para se të analizohet dhe të konkludohet mbi çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal, duke qenë se ky është vendimi i parë njësues që merret pas ndryshimeve të vitit 2016 të Kushtetutës dhe ndryshimeve të

[3] Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 95/2016, gjykatat e posaçme të drejtësisë penale, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, do të jenë dy, sipas parimit të dyshkallësisë së specializuar të gjykimit. Konkretisht, parashikohet të krijohet Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

vitit 2017 të Kodit të Procedurës Penale, vlerëson të nevojshme të ndalet te ndryshimi i nenit 141, të Kushtetutës, te neni 32, i ligjit nr. 98/2016, "*Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*" (në vijim "ligji nr. 98/2016"), dhe nenet 14/a, 432/1/a dhe 437, të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuara. Kjo analizë do të shërbejë për të nxjerrë disa konkluzione për gjykatat, prokuroritë, praktikantët apo studiuesit e së drejtës, lidhur me natyrën juridike të vendimeve njësuese, gjë që në vlerësimin e Kolegjit ka konfuzuar edhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit për krimet e Rënda në vendimin objekt rekursi në këtë gjykim.

Kolegji, në rastin objekt gjykimi, konstaton se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka arsyetuar në vendim ndër të tjera se vendimet e Kolegjit Penal janë vendime njësuese të praktikës gjyqësore, sipas parashikimeve të ndryshuara të Kushtetutës dhe të Kodit të Procedurës Penale. Për të gjitha arsyet që do të sqarohen më poshtë, Kolegji Penal vlerëson se ky konkluzion është i nxituar dhe i gabuar. Kolegji sjell në vëmendje se më parë Gjykata e Lartë nuk ka kaluar çështje për gjykim nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore, lidhur me njësimin e praktikës gjyqësore për çështjet që janë shtruar për zgjidhje në këtë vendim. Por, megjithatë, konstatohet se ka pasur disa vendime të dhomës së këshillimit apo edhe të seancës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që kanë interpretuar ndryshe zbatimin e ligjit procedural penal në kohë dhe kanë vendosur zgjidhje të ndryshme lidhur me mënyrën se si do të ushtrohet juridiksioni penal i prokurorisë dhe i gjykatës pas ndryshimeve të vitit 2016 të Kushtetutës dhe deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKKO-së. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se është vendi dhe janë rrethanat që legjitimojnë vendimmarrjen njësuese të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nuk janë kushtet dhe rrethanat që legjitimojnë Kolegjin Penal apo Kryetarin e Gjykatës së Lartë për të kaluar për gjykim çështjen në Kolegjet e Bashkuara. Në këtë mënyrë, Kolegji Penal nuk po ushtron autoritetin kushtetues dhe ligjor të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi praktika gjyqësore e shtruar për njësim është e paunifikuar dhe e panjësuar më parë. Ajo që Kolegji Penal synon të arrijë nëpërmjet këtij vendimi është njëjtësimi i zgjidhjeve gjyqësore mbi ushtrimin e juridiksionit penal gjatë fazës tranzitore, sipas parashikimeve të ligjeve të ndryshme që regjojnë këtë çështje.

13. Kolegji sjell në vëmendje se paragrafi i dytë i pandryshuar i nenit 141, të Kushtetutës parashikonte, se: "*2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.*". Nga kjo normë kushtetuese kuptohej se unifikimin e praktikës gjyqësore dhe ndryshimin e saj, kishte autoritet ta bënte vetëm trupa gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, qoftë për krijimin e precedentëve fillestarë dhe qoftë për ndryshimin apo zhvillimin e tyre në të ardhmen. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, amendime të cilat hynë në fuqi në datën **11.8.2016**, neni 141 i Kushtetutës parashikon, se: "*1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe me zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. 2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.*".

Kjo do të thotë, se ndryshe nga më parë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk do të mundin më të unifikojnë apo të njësojnë praktikën gjyqësore nëpërmjet krijimit të precedentëve fillestarë jurisprudencialë apo, thënë ndryshe, nuk do të mundet të njësojnë qëndrimet e ndryshme mbi zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykatat më të ulëta. Këtë funksion të nomofilatisë apo të uniformitetit të praktikës gjyqësore do të mundet ta bëjë vetëm Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për çështjet civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet administrative dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për çështjet penale. Këtë funksion kushtetues dhe ligjor, secili prej kolegjeve do ta realizojë nëpërmjet vendimeve njësuese apo, thënë ndryshe, vendimet unifikuese të mëparshme.

Ndërkohë, një çështje do të kalojë për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vetëm atëherë kur vendimet njësuese vlerësohen nga secili prej kolegjeve apo nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, se kanë nevojë të ndryshohen, duke ndryshuar sakaq praktikën gjyqësore për një çështje apo disa të tilla të unifikuara dhe të njësuara më parë nga kolegji respektiv. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 141, pika 2, të ndryshuar, të Kushtetutës, do të gjykojnë edhe çështjet në të cilat secili prej kolegjeve apo kryetari i Gjykatës së Lartë,

kërkojnë të ndryshojnë vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të dhëna më parë ndryshimeve kushtetuese, duke qenë se sot ato janë simotrat e vendimeve njësuese të praktikës gjyqësore. Pikërisht, ky është ndryshimi substancial kushtetues, në mënyrën se si do të njësojë, do të ndryshojë apo do të zhvillojë praktikën gjyqësore Gjykata e Lartë nëpërmjet secilit kolegj apo Kolegjeve të Bashkuara.

14. Për të konkretizuar dhe për të zbatuar në ligj parashikimet e reja të nenit 141 të Kushtetutës, ligji nr. 98/2016, në nenin 32 normoi rastet e kompetencës funksionale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar, se: "*1. Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore. 2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë rastet kur e njëjta çështje juridike nuk është interpretuar në mënyrë të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë ose në rast se ekziston rreziku për interpretim jo të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë.*".

15. Ndryshimet e ligjeve procedurale gjyqësore në vitin 2017 plotësuan dhe detajuan kuadrin ligjor të nevojshëm për të ushtruar Gjykata e Lartë juridiksionin ekskluzivisht ligjor dhe rishikues dhe njëkohësisht edhe nomofilatik, sikurse ndryshimet kushtetuese konturuan. Ndryshimet në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile[4], ndryshimet në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012[5] dhe ndryshimet në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale[6], patën si qëllim të drejtpërdrejtë zbatimin e nenit 141, të ndryshuar, të Kushtetutës. Duke uniformizuar në të tria ligjet procedurale shkaqet e rekursit, mjetit të zakonshëm të ankimit që aktivizon juridiksionin rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, sigurohet ushtrimi kushtetues i juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

16. Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale parashikon, ndër të tjera se: "*1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*".

Këto janë tri kategoritë e shkaqeve që lejojnë ngritjen e një rekursi të pranueshëm për gjykim në Gjykatën e Lartë. Por leximi i kujdesshëm i dispozitës çon në konkluzionin se jo çdo rekurs i kaluar për shqyrtim nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë do të marrë si përgjigje gjyqësore një vendim përfundimtar njësues për praktikën gjyqësore në përmbyllje të gjykimit. Përkundrazi, vetëm rekurset, që në optikën vlerësuese të trupës prej tre gjyqtarësh në Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi vlerëson se ngrenë çështje ligjore materiale dhe procedurale për të cilat praktika gjyqësore duhet të njësohet, vetëm këto gjykime do të mundet të prodhojnë vendime njësuese. Kjo do të thotë se jo çdo vendim përfundimtar i marrë në seancë gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është njësues, por vendime njësuese do të jenë vetëm ato të cilat përmbyllin çështje, të cilat nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore kanë kaluar, me qëllim për të njësuar zbatimin e ligjit në praktikën gjyqësore. Këto vendime të posaçme nomofilatike do të dallohen edhe nga forma, pasi ato në arsyetim ngrenë çështjet për njësim dhe japin zgjidhje me sentencë njësuese për praktikën gjyqësore.

Duke pasur parasysh analizën e mësipërme, Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, që vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të dhëna në seancë gjyqësore, pas datës 1.8.2017, janë vendime njësuese të praktikës gjyqësore, është i pabazuar në nenin 141 të Kushtetutës dhe nenin 14/a, 432 dhe 438, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo analizë dhe ky konkluzion i Kolegjit duhet të shërbejë rast pas rasti për gjykatat, prokuroritë dhe çdo subjekt tjetër për të konkluduar nëse një vendim i secilit prej kolegjeve të Gjykatës së Lartë, i dhënë në seancë gjyqësore, është apo jo njësues për praktikën gjyqësore. Kushdo, në mënyrën se si shquan një vendim njësues nga një vendim të zakonshëm të Gjykatës së Lartë, duhet të mbajë parasysh se vendimi njësues e parashikon shprehimisht këtë cilësi të saj në vendim. Elementi i parë dallues edhe nga pikëpamja e formës është ngritja e çështjeve për njësim të praktikës gjyqësore. Elementi i dytë dallues nga pikëpamja e formës është arritja e

[4] Shiko ligjin nr. 38/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën **5.11.2017**.
[5] Shiko ligjin nr. 39/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën **6.5.2017**.
[6] Shiko ligjin nr. 35/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën **1.8.2017**.

sentencave njësuese mbi çështjet e ngritura për njësimin e praktikës gjyqësore. Dhe elementi eksplicit i formës së tyre do të jetë disponimi nga kolegji respektiv i Gjykatës së Lartë në dispozitivin e vendimit se vendimi është njësues për praktikën gjyqësore. Këto janë disa elemente të formës dhe praktike që do të lejojnë këdo që të kuptojë rast pas rasti statusin kushtetues dhe ligjor të posaçëm të kësaj vendimmarrje të veçantë jurisprudenciale të Gjykatës së Lartë.

17. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje edhe parashikimin e nenit 14/a, të Kodit të Procedurës Penale, dispozitë e cila parashikon, se: "*Gjykata e Lartë shqyrton rekurset në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.*".

Nën të njëjtën logjikë neni 438 i Kodit të Procedurës Penale parashikon, se: "*1. Gjykata e Lartë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore, ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin Penal. 2. Tërheqja e çështjeve bëhet me vendim të kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal. 3. Kolegjet e Bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë. 4. Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të njajshme.*".

Më tej, neni 75/b, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale parashikon, se: "*1. Gjykata e Lartë shqyrton rekurset për shkelje të ligjit, për të siguruar njësimin, zhvillimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe ushtron kompetenca të tjera, sipas parashikimeve të këtij Kodi.*".

18. Në përmbyllje të analizës kushtetuese dhe ligjore mbi vendimet e posaçme nomofilatike apo vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë, Kolegji konkludon, se, ndryshe nga sa parashikohej më parë në Kushtetutë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë do të jenë kompetente për të vendosur vetëm për të ndryshuar praktikën gjyqësore të njësuar më parë nga Kolegji Civil, Administrativ apo Penal, për të ndryshuar vendimet unifikuese të dhëna më parë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë apo për të ndryshuar vendimet që do të jepen në të ardhmen nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ky kuadër kushtetues dhe ligjor kuptohet se njësimi i praktikës gjyqësore, pas ndryshimeve kushtetuese, nuk është më në kompetencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por është në kompetencën e Kolegjit Penal për çështjet penale, Kolegji Civil për çështje civile dhe Kolegjit Administrativ për çështje administrative. Kolegji konkludon se me njësim të praktikës gjyqësore do të thotë unifikimi i qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore të gjykatave më të ulëta apo unifikimin e qëndrimit të kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë të mbajtura në vendimet e zakonshme të tyre, mbi zbatimin e një apo disa normave ligjore dhe se kjo kompetencë nomofilatike i është njohur nga Kushtetuta dhe ligjet procedurale secilit kolegj të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë, Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar se krijimi i precedentit të parë apo krijimi i precedentit fillestar mbi një çështje civile, penale apo administrative nga ana e Gjykatës së Lartë, do të bëhet nga secili kolegj respektiv, duke vendosur njësimin e praktikës gjyqësore të ndryshme të mbajtur më parë nga gjykatat.

iii) Lidhur me çështjen e parë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore

a) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale për të cilat procedimi penal ka nisur para datës 1.8.2017, ndërmjet prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të posaçëm penal? Pra, cila prokurori do të ushtrojë ndjekjen penale dhe do të përfaqësojë akuzën në gjyq për veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur para datës 1.8.2017?

19. Lidhur me çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson të nevojshme se, para se të analizohet dhe konkludohet mbi çdo pyetje të shtruar për njësim, duhet të analizohet në mënyrë kronologjike i gjithë vëllimi kushtetues dhe ligjor që rregullon juridiksionin penal të përgjithshëm dhe të posaçëm të ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit të akuzës në gjyq apo edhe të gjykimit sipas shkallëve. Për qëllimet e qartësimit të qëllimit që ka pasur legjislatori në parashikimet kushtetuese dhe ligjore ndër vite, do të analizohet kuadri kushtetues para dhe pas ndryshimeve dhe kuadri ligjor respektiv para dhe pas ndryshimeve kushtetuese.

20. Neni 135 i Kushtetutës së vitit 1998, të pandryshuar, parashikonte se: "*1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. 2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.*". Nga leximi i kësaj dispozite kuptohet se Kushtetuta mjaftohej vetëm me individualizimin, në mënyrë shteruese se në sa shkallë ushtrohet dhe përbëhet pushteti gjyqësor, duke përcaktuar nën një rezervë ligjore se krijimi i gjykatave të çdo shkalle do të bëhet me ligj. Nga pika dy kuptohej se si rregull gjykatat do të kenë juridiksion të përgjithshëm, porse Kuvendi, me ligj, mundet të krijonte, kur e vlerësonte të nevojshme, edhe gjykata, me juridiksion të posaçëm dhe të specializuar për fusha të veçanta, duke ndaluar me rezervë kushtetuese dhe të paderogueshme krijimin e gjykatave të jashtëzakonshme, qoftë me juridiksion të përgjithshëm dhe qoftë me juridiksion të posaçëm.

Nga ana tjetër, juridiksionin gjyqësor në përgjithësi e përcakton neni 42 dhe 43 i Kushtetutës. Neni 42 parashikon se juridiksionit fillestar gjyqësor do t'i adresohen pretendimet e kujtdo subjekti për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, duke u formuluar, ndër të tjera se: "*2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*". Neni 43 parashikon se gjykatave me juridiksion rishikues mundet t'i drejtohet kushdo, i gjykuar nga një gjykatë më e ulët, për të kontestuar kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke u formuluar pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, se: "*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.*". Ligji, më tej, detajon mënyrën dhe kriteret e atribuimit të kompetencës.

21. E vetmja dispozitë e Kushtetutës, e cila derogonte nga kjo mënyrë parimore e rregullimit të juridiksionit dhe e kompetencës së pushtetit gjyqësor dhe gjykatave, ishte neni 141, pika 1 e Kushtetutës, së pandryshuar. Kjo pjesë e dispozitës i njihte Gjykatës së Lartë juridiksion fillestar, në rastet kur gjykonte akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

22. Me ligjin nr. 9110, datë 24.7.2003, "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda*", u krijuan dy shkallë gjykimi me juridiksion të posaçëm penal, konkretisht Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, gjykata të cilat kanë nisur veprimtarinë në datën 1.1.2004. Neni 5 i këtij ligji, nëpërmjet një dispozite blankete, parashikon ndër të tjera se: "*1. Gjykata për krime të rënda dhe gjykata e apelit për krime të rënda gjykojnë në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë veprat penale të parashikuara nga neni 75 shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale.*".

Neni 74, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, parashikonte se: "*1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda dhe Gjykatës së Lartë.*". Në këtë mënyrë, kompetenca lëndore penale e gjykatave të zakonshme përcaktohej me karakter mbetës, që do të thotë se çfarë veprash penale nuk parashikoheshin si kompetencë lëndore e posaçme e gjykatave për krimet e rënda dhe e Gjykatës së Lartë ishte në kompetencën lëndore të gjykatave të zakonshme dhe me juridiksion të përgjithshëm.

Paragrafi i dytë i nenit 75/b, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, parashikonte se: "*2. Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit.*". Kjo dispozitë përsëriste parashikimin e nenit , pika 1, të pandryshuar, të Kushtetutës.

Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, para datës 1.8.2017, nën titullin "*Kompetencat e gjykatës për krimet e rënda*", parashikonte se: "*Gjykata e krimeve të rënda gjykon krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 78/a, 79, shkronja "ç", 79/a, 79/b, 79/c, 109, 109/b, 110/a, 111, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 234/b, 245, 260, 265/a, 265/b, 265/c, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 319, 319/ç, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga të*

miturit.". Thënë në mënyrë shteruese dhe më të konkretizuar, gjykatat për krimet e rënda kanë në kompetencë lëndore gjykimin fillestar në shkallë të parë dhe rishikues në apel të veprave penale:

- Genocidi;

- Krime kundër njerëzimit;

- Krimet e luftës;

- Vrasja për gjakmarrje;

- Vrasja me dashje e kryer ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse;

- Vrasja e funksionarëve publikë;

- Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit;

- Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare;

- Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit;

- Shtrëngimi me anë të kanosjes ose të dhunës për dhënien e pasurisë;

- Trafikimi i personave të rritur;

- Rrëmbimi i avionëve, i anijeve dhe i mjeteve të tjera;

- Trafikimi i të miturve;

- Atentati;

- Komploti;

- Kryengritja;

- Vepra me qëllime terroriste;

- Financimi i terrorizmit;

- Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin;

- Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit;

- Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;

- Krijimi i turmave të armatosura;

- Prodhimi i armëve luftarake;

- Organizata terroriste;

- Banda e armatosur;

- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;

- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë;

- Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj;

- Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj;

- Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj;

- Trafikimi i armëve dhe i municionit;

- Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive;

- Trafikimi i narkotikëve;

- Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale;

- Çelja e llogarive anonime;

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, i prokurorëve dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë;

- Organizata kriminale;

- Grupi i strukturuar kriminal;

- Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal;

- dhe të gjitha veprat penale të individualizuara më lart kur janë kryer nga të miturit.

23. Në datën 11.8.2016 hynë në fuqi ndryshimet e Kushtetutës, në kuadër të paketës normative të Reformës në Drejtësi. Në dallim nga sa parashikohej më parë në nenin 135 të Kushtetutës, së pandryshuar, amendimet e kësaj dispozite në pikën 2 parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale, kompetenca lëndore e së cilës parashikohej drejtpërdrejt në Kushtetutë, njëlloj sikurse parashikohej juridiksioni fillestar penal i Gjykatës së Lartë në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës, së pandryshuar.

Kështu, neni 135 i Kushtetutës, në pikën 2, parashikon se: "*2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.*".

Më tej, ndryshimet kushtetuese prekën edhe nenin 148 të Kushtetutës, ku ndër të tjera u përcaktua edhe kompetenca lëndore e ndjekjes penale dhe e përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë. Pika 4 e kësaj dispozite kushtetuese parashikon, se: "*Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.*".

24. Amendimet e Kushtetutës rregulluan në mënyrë të përgjithshme edhe fazën tranzitore të fundit të ekzistencës së gjykatave dhe të prokurorive për krimet e rënda dhe krijimin rishtazi të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme. Neni 179, pika 8, e Kushtetutës, parashikon se: "*8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit*

për Krimet e Rënda do të emërtohen, do të funksionojnë dhe do të ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët, pranë Prokurorisë së Posaçme, do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.".

Nga kjo mënyrë e të normuarit në nivel kushtetues kuptohet se edhe gjykatat edhe prokuroritë për krimet e rënda do të vijojnë të funksionojnë deri në krijimin e kushteve për konstituimin e Gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme, që individualizohet në nenin 135, pika 2 dhe në nenin 148, pika 4 të Kushtetutës. Më tej, kuptohet se edhe neni 135, pika 2, i Kushtetutës, për gjykatën e posaçme, edhe neni 148, pika 4, i Kushtetutës, për Prokurorinë e Posaçme, nuk janë dispozita kushtetuese, që në bazë dhe për zbatim të nenit 4, pika 3, të Kushtetutës, zbatohen drejtpërsëdrejti. Përkundrazi, nga vetë këto dy dispozita dhe nga dispozita tranzitore kushtetuese, jepet mesazhi se konstituimi i organeve të posaçme të procedimit penal, sipas kompetencës lëndore kushtetuese të specializuar, do të duhet të bëhet sipas ligjit organik të tyre apo sipas një ligji procedural penal, që do të duhej të miratohej më vonë nga Kuvendi.

25. Ndryshimet kushtetuese prekën edhe juridiksionin fillestar penal të Gjykatës së Lartë, duke e hequr këtë atribut të ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga kjo gjykatë dhe duke e bërë pjesë integrale të juridiksionit të specializuar penal të gjykatës së posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Njëlloj, juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale dhe i përfaqësimit të akuzës në gjyq i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas nenit 141, pika 1, të pandryshuar të Kushtetutës, i kaloi Prokurorisë së Posaçme. Nga kjo mënyrë e rregullimit kushtetues problem në praktikë do të krijonte çështja se cila prokurori do të ushtrojë ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe cila gjykatë do të gjykojë kërkesat për gjykim të prokurorisë për lëndën e gjykimit të veprave penale që përbënin vëllimin kushtetues të juridiksionit penal fillestar të Gjykatës së Lartë, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Duke pasur parasysh dispozitën tranzitore kushtetuese të sjellë në vëmendje më lart, konkludohet se edhe kjo çështje duhet të rregullohej me ligj.

Ndryshimet e nenit 141, pika 1, të Kushtetutës dhe heqja në mënyrë kategorike të juridiksionit fillestar penal nga Gjykata e Lartë, përbën një dispozitë drejtpërdrejt të zbatueshme, sipas nenit 4, pika 3 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se në datën **11.8.2016**, ditë kur ndryshimet kushtetuese hynë në fuqi, Gjykata e Lartë nuk kishte më juridiksion fillestar mbi akuzat penale që mundet të paraqiteshin rishtazi në gjyq pas kësaj date ndaj subjekteve që listonte pika 1, e nenit 141, të pandryshuar, të Kushtetutës. Kjo do të thotë, se në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, automatikisht ndryshoi edhe neni 74 dhe 75/b i Kodit të Procedurës Penale, pasi në kompetencën e përgjithshme të gjykatave të zakonshme erdhën me karakter mbetës edhe veprat penale të kryera nga subjektet e listuara në ish-nenin 141, pika 1, të Kushtetutës dhe nga ana tjetër Gjykatës së Lartë iu hoq kompetenca lëndore dhe juridiksioni fillestar mbi këto vepra penale. Kjo do të thotë, se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, neni 74 i Kodit të Procedurës Penale duhet të lexohej dhe të zbatohej sikur të ishte: "*1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda*". Nga ana tjetër neni 75/b i Kodit të Procedurës Penale duhet të lexohej dhe të zbatohej sikurse e kishte të shfuqizuar edhe formalisht pikën 2.

26. Nga dispozitat kushtetuese të ndryshuara dhe të sjella në vëmendje më lart, konkludohet se njëlloj sikurse prokuroritë për krimet e rënda, Prokuroria e Posaçme, në momentin e krijimit, do të ketë në kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq për veprat penale:

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, i prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, i prokurorëve dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë;

- Veprat penale të krimit të organizuar.

Ndryshe nga kompetenca lëndore penale e prokurorive të krimeve të rënda, Prokuroria e Posaçme, në momentin e krijimit, parashikohet se do të ketë si kompetencë lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq edhe për veprat penale, si më poshtë:

- Akuzat penale kundër Prokurorit të Përgjithshëm, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zëvendësministrit, drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

- Akuzat penale kundër ish-Prokurorit të Përgjithshëm, ish-anëtarëve të Këshillit të Ministrave, ish-zëvendësministrave, ish-deputetëve, ish-kryetarëve të bashkisë; ish-drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

- Çdo akuzë për veprat penale të korrupsionit.

I njëjti ndryshim në vëllimin e kompetencave lëndore vlen edhe për GJKKKO-në, në raport me gjykatat për krimet e rënda, qoftë për gjykimin në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë. Nga konkluzionet e arritura më lart për dispozitën tranzitore të Kushtetutës, rrjedh si konkluzion, se deri në momentin e krijimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë penale, me juridiksion të posaçëm kushtetues, institucionet pararendëse dhe ato që aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre do të veprojnë të pandryshuara, sipas ligjit të tyre organik dhe ligjeve materiale dhe procedurale në fuqi. Nga kjo kuptohet se transformimet e institucioneve të dhënies së drejtësisë dhe të ndjekjes penale të posaçme, sikurse parashikohen nga neni 135, pika 2 dhe 148, pika 4 të Kushtetutës, do të zbatohen në momentin e krijimit të GJKKKO-së dhe të Prokurorisë së Posaçme.

27. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi miratoi ligjin nr. 95/2016, "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*" (në vijim "ligji nr. 95/2016"). Ligji, në klauzolën e hyrjes në fuqi, parashikonte se hyrja në fuqi e tij do të bëhej 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji nr. 95/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 194 të vitit 2016, në datën 20.10.2016, që do të thotë se ka hyrë në fuqi në datën **4.11.2016**. Neni 8 i këtij ligji parashikon, se: "*1. Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji ose, nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit.*".

Më tej, neni 9 i këtij ligji rregullon edhe kompetencën dytësore lëndore të gjykatave të posaçme, duke parashikuar se: "*1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji. 2. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe për goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. 3. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. 4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kompetenca mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen.*".

28. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, neni 74 dhe 75/a i Kodit të Procedurës Penale, akoma nuk ishin ndryshuar, ndaj ligji kujdeset që në rast se Prokuroria e Posaçme apo GJKKKO-ja krijohen para përditësimit të kësaj dispozite procedurale, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, atëherë këto institucione të kenë parasysh se nenet 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale, do të jetë i zbatueshëm vetëm për aq sa përputhet me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës. Më tej, edhe neni 135, pika 2, i Kushtetutës dhe nenet 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale do të komplementoheshin me parashikimet e nenit 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe, në këtë mënyrë, do të konturohej kompetenca lëndore në mënyrë shteruese e organeve të posaçme kushtetuese të drejtësisë penale.

29. Ligji nr. 95/2016 parashikoi edhe dispozita tranzitore që do të siguronin vazhdimësinë e

gjykatave dhe të prokurorive për krimet e rënda, deri në momentin e krijimit të GJKKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 135, pika 2 dhe 148, pika 4 të Kushtetutës. Pika 1 dhe 2, e nenit 57 të këtij ligji, në mënyrë blankete referojnë në rregullimet tranzitore të ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" (në vijim "ligji nr. 96/2016"), duke parashikuar se dispozitat kalimtare për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe për prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda pranë shkallës së parë dhe të dytë. Në ligjin nr. 96/2016, konkretisht në dispozitat tranzitore të neneve 162 për gjyqtarët dhe 163 për prokurorët, parashikohet, se deri në krijimin e GJKKKO-së dhe të Prokurorisë së Posaçme, gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda dhe prokurorët për krimet e rënda qëndrojnë në detyrë. Pas krijimit të gjykatave dhe të prokurorisë së posaçme, gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave për krimet e rënda, nëse kalojnë me sukses procesin kalimtar të rivlerësimit, do të emërohen rishtazi respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë në GJKKKO dhe në Prokurorinë e Posaçme. Pra duket se të dyja ligjet organike, në sintoni me nenin 178, pika 8, të Kushtetutës, sanksiononin si zgjidhje parimin e vazhdimit të institucioneve pararendëse me funksione të plota deri në momentin e transformimeve institucionale të sistemit të drejtësisë penale sipas ndryshimeve të Kushtetutës. Momenti juridik që do të përfaqësonte suprimimin e prokurorive dhe të gjykatave për krimet e rënda, afërmendsh pasi të ishte konstituuar dhe pasi të kishte filluar funksionimin Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, do të ishte konstituimi nga e para e institucioneve të reja kushtetuese të drejtësisë penale, konkretisht Prokuroria e Posaçme dhe GJKKKO-ja.

30. Ligji nr. 95/2016, në nenin 57, parashikoi edhe rregullimin e parë tranzitor konkret ligjor mbi kompetencën e gjykatave dhe të prokurorive për krimet e rënda gjatë fazës së tranzimit institucional nga gjykatat dhe nga prokuroritë e krimeve të rënda dhe deri në momentin e krijimit të gjykatave dhe të Prokurorisë së Posaçme. Pikat 5 e nenit 57 të këtij ligji parashikonte, se: "*5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar". Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.*". Kjo ishte dispozita e parë më konkrete dhe e plotë tranzitore që vendoste kritere atribuimi të kompetencës lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe për përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale, që sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, përbëjnë ekskluzivisht kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Kjo do të thotë, se:

a) Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, do të duhet të ushtronin juridiksionin fillestar për ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për të gjitha veprat penale që nuk përshiheshin në nenin 141, pika 1, të pandryshuar, të Kushtetutës dhe në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale;

b) Prokuroria e Përgjithshme do të ushtronte juridiksionin fillestar të ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale të parashikuara në nenin 141, pika 1, të pandryshuar, të Kushtetutës, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme;

c) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda do të duhet të ushtronte ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për të gjitha veprat penale që parashikohen në listën shteruese të nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale.

Kështu, ligji vendoste që ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq do të ushtrohej nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga prokuroria pranë gjykatës për krimet e rënda, sipas kuadrit ligjor që ishte në fuqi para ndryshimeve kushtetuese apo para datës 11.8.2016. Kjo mënyrë tranzitore e ushtrimit të ndjekjes penale dhe e përfaqësimit të akuzës në gjyq nga të tria llojet e prokurorive, konkretisht prokuroritë e zakonshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë për krimet e rënda, do të ushtrohej deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme. Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha procedimet penale në fazën e hetimeve paraprake apo në gjykim, sipas asaj që liston neni 135, pika 2, i

Kushtetutës dhe nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016, pavarësisht gjendjes së procedimit apo të shkallës së gjykimit dhe pavarësisht se kush prokurori kishte çështjen, do të transferoheshin menjëherë për ndjekje në Prokurorinë e Posaçme. Nga kjo rrjedh konkluzioni, se sipas këtij ligji ,detyrimin për të transferuar çështjet e kanë:

a) Prokuroritë e zakonshme për të gjitha akuzat penale që nuk përfshiheshin te neni 141, pika 1, i pandryshuar, i Kushtetutës dhe nuk përfshihen në nenin 75/a, të pandryshuar në vitin 2017, të Kodit të Procedurës Penale;

b) Prokuroria e Përgjithshme për të gjitha akuzat penale që përfshiheshin te neni 141, pika 1, i pandryshuar, i Kushtetutës;

c) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për të gjitha veprat penale që parashikohen në listën shteruese të nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016;

ç) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për të gjitha veprat penale që parashikohen në listën shteruese të nenit 75/a, të pandryshuar të Kodit të Procedurës Penale dhe që nuk parashikohen në listën shteruese të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016. Këto çështje do të transferoheshin në prokuroritë respektive të juridiksionit penal të përgjithshëm, pasi prokuroritë për krimet e rënda në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme do të suprimoheshin.

31. Pika 6 e nenit 57, në rregullimet tranzitore të ligjit nr. 95/2016, parashikonte se: "*6. Në mënyrë që të respektohet e drejta e të pandehurve për një gjykim të drejtë, çështjet që do të jenë në gjykim para gjykatave për krimet e rënda në ditën e 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten nën kompetencën e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëse ato nuk bëjnë pjesë në kompetencën parësore apo dytësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas këtij ligji. Këto çështje ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme.*".

Kjo pjesë e dispozitës e nis normimin duke treguar qëllimet që ka dispozita gjatë tranzitimit të institucioneve të drejtësisë me juridiksion të posaçëm penal, që do të thotë se edhe interpretimi i tyre do të duhet të bëhet duke pasur parasysh këtë qëllim të ligjvënësit. Kjo do të thotë se konkluzioni i interpretimit, ndërmjet disa syresh të mundshëm, duhet të jetë ai që garanton elementet e gjykimit të drejtë dhe të procesit të rregullt ligjor. Kjo pjesë e dispozitës vendos se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do vijojnë të ushtrojnë porcionet e juridiksionit të pushtetit gjyqësor, sikurse parashikon neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, deri në ditën e krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në momentin e krijimit të Gjykatës së Posaçme, të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, dispozita parashikon se të gjitha çështjet që kanë në gjykim gjykatat e krimeve të rënda do të kalohen respektivisht te gjykatat pasardhëse të posaçme, pavarësisht nëse janë apo jo në kompetencën lëndore parësore të neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016.

Kjo do të thotë se kjo dispozitë parashikonte se të gjitha çështjet, sipas nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që janë në gjykim te gjykatat për krimet e rënda, ditën e krijimit të GJKKKO-së, do të kalojnë te këto të fundit, pavarësisht se nuk parashikohen në listën e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016, dhe se kjo zgjidhje përjashtimore, sipas ligjit, kushtëzohej nga nevoja për t'u garantuar të gjykuarve gjykim të drejtë. Kjo pikë e dispozitës, sërish nën një zgjidhje, përjashtim nga rregulla, parashikonte se ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq, edhe për veprat që nuk parashikon neni 135, pika 2, e Kushtetutës dhe nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016, të cilat transferoheshin nga gjykatat për krimet e rënda te GJKKKO-ja, ushtrohet nga Prokuroria e Posaçme.

Pika 7 e dispozitës tranzitore të ligjit nr. 95/2016, merrte përsipër të vendoste një afat ligjor maksimal për kalimin e kompetencave lëndore te gjykatat e posaçme dhe te Prokuroria e Posaçme, duke parashikuar se në mesnatën e ditës së 300-, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kompetencat e parashikuara nga nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016, u kalojnë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme. Ndërsa, në pikën 8, neni 57, i ligjit nr. 95/2016, parashikonte se ligji nr. 9110, datë 24.7.2003, "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda*", shfuqizohet në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Afati 300-ditor mbaronte në datën **1.9.2017**.

32. Ajo që kuptohet nga fryma e rregullimit të dispozitës është sintonia me rregullimin tranzitor të Kushtetutës, që do të thotë se ligji procedural penal do të vazhdojë të atribuojë kompetencën lëndore për ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe gjykimin, qoftë për prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave për krimet e rënda, edhe për gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatave të apeleve dhe gjykatave për krimet e rënda, sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se neni 135, pika 2 dhe 148, pika 4 e Kushtetutës dhe neni 8 dhe 9, i ligjit nr. 95/2016, do të fillonin të zbatoheshin ditën e krijimit të GJKKKO-së dhe të Prokurorisë së Posaçme. Kjo zgjidhje e posaçme është bërë me qëllim për të garantuar parimin e *perpetuatio juridictionis* (parimi i vazhdimësisë së juridiksionit) dhe *perpatuatio fori* (parimi i vazhdimësisë së kompetencës), parimin e gjyqtarit natyral dhe për të garantuar afatin e arsyeshëm në gjykim, elemente kryesore këto të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

33. Në të vërtetë parashikimi i pikave 7 dhe 8, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, nuk u arrit të zbatohej dhe të përmbushej për një sërë arsyesh praktike që ndodhën nga zbatimi i dispozitave të ndryshuara të Kushtetutës apo ligjeve organike të institucioneve të reja kushtetuese. Vonesa në ngritjen e institucioneve të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, e për rrjedhojë, pamundësia e krijimit në kohë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bëri që të ishte e pamundur respektimi i afateve kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e institucioneve kushtetuese të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet kushtetuese të posaçme të drejtësisë penale.

34. Një ndërhyrje tjetër në ligj, që tregon vullnetin dhe qëllimin e ligjvënësit për mënyrën se si do të atribuohej kompetenca lëndore penale e përgjithshme dhe e posaçme deri në momentin e krijimit të institucioneve kushtetuese të reja të drejtësisë penale, është edhe ndryshimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar*"[7] (në vijim "ligji nr. 10192/2009").

Kuvendi, në datën 27.4.2017, miratoi ligjin nr. 70/2017, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar*"[8] (në vijim "ligji nr. 70/2017"). Neni 35, nën titullin "*Dispozitë kalimtare*", parashikon se:

"*1. Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij.*

2. Për procedimet pasurore në fazën e hetimit, ky ligj fillon të zbatohet me hyrjen e tij në fuqi.

3. Për pasuritë e vëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë lidhje me veprat penale të reja që shtohen në nenin 3, pika 1, të tij, zbatohen parashikimet e pikës 6, të nenit 3, të këtij ligji.

4. Deri në krijimin e Gjykatës së kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda.

5. Me krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë gjykatë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

6. Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në hetim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë prokurori dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.".

35. Këto amendime ligjore kanë hyrë në fuqi në datën **21.6.2017**. Kjo dispozitë tranzitore e ligjit ngjan të jetë dispozita më e qartë mbi kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit

[7] Shiko ligjin nr. 70/2017, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar*".

[8] Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, viti 2017, në datën 22.5.2017, dhe ka hyrë në fuqi në datën **21.6.2017**, duke qenë se klauzola e hyrjes në fuqi, konkretisht, neni 36, parashikonte se ligji hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Shiko në *web*: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/113-2017.pdf.

të akuzës në gjyq dhe gjykimit, ndërmjet prokurorive dhe gjykatave për krimet e rënda dhe prokurorive dhe gjykatave të zakonshme, nga të gjitha dispozitat simotra që janë miratuar që nga ndryshimet e vitit 2016 të Kushtetutës e deri në nenin 285, të ligjit nr. 35/2017, që ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2017. Ky ligj rregullon, jo kompetencën lëndore parësore të gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme, por një pjesë të kompetencës lëndore dytësore, sipas përcaktimeve të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016. Duke qenë se me këtë ligj u ridimensionua rrethi i veprave penale për të cilat mundet të merren masa parandaluese ndaj pasurisë së pajustifikuar, ligji kujdeset në dispozitat tranzitore të rregullojë ndarjen dhe ushtrimin e kompetencës lëndore ndërmjet prokurorive dhe gjykatave për krimet e rënda dhe prokurorive dhe gjykatave të zakonshme, deri në momentin kur do të konstituohen GJKKKO-ja dhe Prokuroria e Posaçme.

Nën të njëjtën logjikë që nxirret nga interpretimi i nenit 178, pika 8 e Kushtetutës dhe pikat 5–8 të ligjit nr. 95/2016, rregullon edhe këtë pjesë respektive të kompetencës lëndore dytësore gjatë fazës tranzitore, dispozita kalimtare e ligjit nr. 70/2017. Kjo dispozitë parashikon, se deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, hetimin dhe përfaqësimin në gjyq për të gjitha masat parandaluese kundër pasurisë, që kanë lidhje me veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, do të jetë në kompetencën e prokurorive të krimeve të rënda. Njëlloj edhe gjykimi i kërkesave apo i apeleve të prokurorive për krimet e rënda, deri në momentin e krijimit të GJKKKO-së, do të jetë në kompetencën lëndore të gjykatave për krimet e rënda. Ndërkohë, masat e tjera parandaluese mbi pasurinë, që kanë lidhje veprat penale jo në kompetencën lëndore të prokurorive dhe gjykatave për krimet e rënda, do të jenë në kompetencën lëndore të prokurorive dhe gjykatave të zakonshme. Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKKO-së, të gjitha çështjet në hetim dhe në gjykim nga prokuroritë dhe gjykatat e krimeve të rënda dhe prokuroritë apo gjykatat e zakonshme, që kanë si objekt masat parandaluese ndaj pasurisë për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, do të kalojnë për hetim, përfaqësim në gjyq dhe gjykim tek institucionet e posaçme dhe rishtazi të konstituuara.

36. Më tej, nën ato kushte dhe rrethana faktike të krijuara me nenin 57, të ligjit nr. 95/2016, ligjvënësi u detyrua që të ndërhyjë në dispozitat tranzitore në paketën e ndryshimeve të ligjit nr. 35/2017, që amendoi Kodin e Procedurës Penale. Këto parashikime synuan ndër të tjera të riformonin dhe të rirregullonin regjimin juridik tranzitor të kompetencës lëndore të gjykatave dhe të prokurorive për krimet e rënda deri në momentin e paparashikueshëm tashmë të krijimit të GJKKKO-së dhe të Prokurorisë së Posaçme. Njëkohësisht, lindi nevoja e rirregullimit të pikës 6–8, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, për shkak se data **1.9.2017** po vinte shpejt dhe se kjo datë përkonte me mbarimin e afatit 300-ditor në të cilit do të shënohej shfuqizimi i ligjit organik i gjykatave për krimet e rënda.

37. Sipas nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, me titull "*Dispozita kalimtare*", u parashikua se:

"*1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.*

2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.

3. Aktet dhe provat e marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe të përdorshme edhe në rastet kur ky ligj parashikon rregullime të ndryshme.

4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

6. Pikat 6, 7 dhe 8, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të

luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", shfuqizohen.

7. Përbërja e trupave gjykues rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.".

38. Sipas klauzolës së hyrjes në fuqi të ligjit amendues, konkretisht nenit 286 të ligjit nr. 35/2017, ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi në datën **1.8.2017**. Kjo do të thotë se pikat 6–8, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, janë shfuqizuar para se të zbatoheshin dhe se ligji nr. 9110, datë 24.7.2003, "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda*" mbeti në fuqi edhe pas datës 1.9.2017.

39. Neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, nën titullin "*Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*", me qëllim përditësimin e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës në ligjin procedural, parashikon se: "*Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) Krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) Çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.*". Ndërkohë, neni 74, i ndryshuar edhe formalisht i Kodit të Procedurës Penale, i cili rregullonte kompetencën lëndore të juridiksionit të përgjithshëm penale, parashikon se: "*1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.*".

Ajo që neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar ka sjellë si risi, në raport me nenin 135, pika 2 të Kushtetutës dhe neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016, është konkretizimi i dispozitave të Kodit Penal që kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, individualizimi eksplicit i formave që Kodi Penal njeh për krimin e organizuar dhe ngushtimi i juridiksionit të posaçëm penal për akuzat ndaj ish-funksionarëve të cituar në mënyrë shteruese nga neni 135, pika 2 e Kushtetutës. Ndërkohë që Kushtetuta jep juridiksion të posaçëm penal për të gjitha akuzat penale kundrejt ish-funksionarëve, neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, atribuon si kompetencë lëndore të GJKKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, vetëm akuzat penale ndaj ish-funksionarëve shtetërorë, kur vepra penale objekt procedimi është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

40. Nga i gjithë ky rregullim i ri ligjor tranzitor i kompetencës lëndore të GJKKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme del se baza ligjore e zbatueshme për zgjidhjen e çdo dileme përkatësie të kompetencës lëndore ndërmjet prokurorive dhe gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm është pika 5, e nenit 57, të ligjit nr. 95/2016 dhe pikat 1, 2, 4 dhe 5 të dispozitës tranzitore të Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar (neni 285 i ligjit nr. 35/2017). Kjo do të thotë se normat e tranzitore të zbatueshme, të bashkuara dhe të vendosura për lehtësi interpretimi në një të vetme do të ishte:

a) *5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar". Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.*

b) *1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.*

c) *2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.*

ç) *4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit, të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së*

Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

d) *5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit, të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.*

41. E para mungesë koherence që vihet re në këtë dispozitë tranzitore të supozuar dhe të bashkuar për arsye praktike të të dyja ligjeve të veçanta është, se, ndërkohë që pika 5, e ligjit nr. 95/2016, i jep juridiksion fillestar për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq Prokurorisë së Përgjithshme, për veprat penale të parashikuara në nenin e pandryshuar 141, pika 1, të Kushtetutës, pika 4, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ka parashikuar se çdo vepër penale jashtë nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale është në juridiksionin fillestar të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq të prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Nga ana tjetër, ushtrimi i juridiksionit fillestar për ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për çdo procedim penal në kompetencën e Prokurorisë së Përgjithshme, me objekt vepra penale që futen në rrethin e nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, do të ishte, nga data 1.8.2017, në kompetencën lëndore të prokurorive për krimet e rënda, sipas pikës 4, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017. Pikërisht data 1.8.2017 është momenti kur Prokuroria e Përgjithshme humbi juridiksionin fillestar për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq për llogari të prokurorive të zakonshme dhe prokurorive për krimet e rënda. Pjesa tjetër e dy pikave të dy dispozitave të ligjeve të ndryshme në ushtrimin e juridiksionit fillestar të ndjekjes penale dhe ët përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë e krimeve të rënda e rregullojnë njëlloj.

Kjo do të thotë se, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca lëndore mbi veprat penale që liston në mënyrë shteruese, neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, do të ushtrohet, respektivisht, në varësi të gjendjes së procedimit penal, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet për të cilat po zhvillohen hetimet paraprake, përfaqësimi i akuzës në gjyq, përfaqësimi i prokurorisë në gjykime penale të tjera të nisura nga ajo apo nga palë kërkuese të tjera, gjatë fazës së hetimit paraprak apo gjykimit, apo përfaqësimi i akuzës në gjykatën apelit apo në Gjykatën e Lartë, Kolegjin Penal apo Kolegjet e Bashkuara, apo çështjet gjykimet e të cilave janë në Gjykatën Kushtetuese ku prokuroria është legjitimuar si palë e interesuar, do të transferohen tek institucioni i ri i posaçëm i ndjekjes penale i parashikuar nga neni 148, pika 4 e Kushtetutës.

Kjo do të thotë, se pavarësisht se nenet 74 dhe 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 dhe ndryshimet ligjore të ligjit procedural penal kanë hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, sipas dispozitave tranzitore të vetë ligjit amendues dhe të pikës 5, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, për qëllimet e ushtrimit të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq, kompetenca lëndore ndërmjet prokurorive pranë gjykatave për krimet e rënda dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit apo Prokurorisë së Përgjithshme, do të regjohen sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se neni 75/a, i ndryshuar i Kodit të Procedurës Penale do të hyjë në fuqi datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme. Të njëjtin fat do të ketë edhe neni 74, i ndryshuar, edhe formalisht i Kodit të Procedurës Penale.

42. Kolegji Penal vlerëson, se pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ka një mungesë rregullimi të plotë ligjor tranzitor për sa i përket përcaktimit të kompetencës lëndore të prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale në hetim dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në gjykim. Dispozita rregullon vetëm kompetencën lëndore të prokurorive të krimeve të rënda, prokurorive të zakonshme dhe Prokurorisë së Posaçme, vetëm për çështjet penale që janë në hetim dhe jo për çështjet penale që janë në gjykim. Kjo do të thotë se të lëna pa rregullim ligjor tranzitor mbeten çështjet të cilat janë dërguar tashmë në gjyq, qoftë nga prokuroritë për krimet e rënda dhe qoftë për prokuroritë e posaçme. Në këto kushte, me qëllim qartësimin e praktikës gjyqësore dhe njësimin e saj mbi këto mangësi të

rregullimit ligjor, Kolegji Penal vlerëson se ka vend për sqarimin dhe njësimin e praktikës gjyqësore edhe për mënyrën se si do të procedohet me kompetencën e prokurorive, pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, për çështjet të cilat janë në hetim dhe për ato që janë në gjykim.

Kolegji Penal vlerëson se, në rastin e çështjeve në hetim dhe në gjykim, që do të ndodhen te prokuroritë për krimet e rënda ditën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar (*lato sensu*), në kuptimin se, duke qenë se prokuroritë për krime të rënda suprimohen si institucione, te Prokuroria e Posaçme, nuk do të kalojnë vetëm çështjet në hetim, por edhe çështjet për të cilat faza e hetimit paraprak është mbyllur dhe është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq apo është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq nga gjyqtari i seancës paraprake. Kuptohet që ky interpretim i kësaj pjese të dispozitës u përket vetëm procedimeve penale, lëndë e të cilave është një nga veprat penale të listuara në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë njëjtën kohë, pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se prokuroritë e krimeve të rënda suprimohen, të gjitha çështjet në hetim dhe në gjykim që ajo ka, që nuk përfshihen më në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, do të transferohen në prokuroritë respektive me juridiksion të zakonshëm. Zbatimi *stricu sensu* i pikës 5, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, që do të thotë se vetëm çështjet në hetim të prokurorisë për krimet e rënda do t'i kalojnë Prokurorisë së Posaçme dhe se çështjet e dërguara tashmë për gjykim do t'u dërgohen prokurorive me juridiksion të përgjithshme, do të passillte konkluzione jo në pajtim me nenin 148, pika 3, të Kushtetutës. Kjo pasi, çështjet të cilat do të dërgohen për gjykim nga gjykatat për krimet e rënda te GJKKKO-ja do të kenë si prokurori kërkuese apo si prokuror seance jo Prokurorinë e Posaçme apo prokurorë të posaçëm por prokurori të zakonshme dhe prokurorë të zakonshëm. Ndaj, Kolegji vlerëson të nevojshme dhe të domosdoshme për të interpretuar në këtë mënyrë pjesën e parregulluar drejtë të pikës 5, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017. Kjo mënyrë interpretimi pajtohet edhe me regjimin juridik të vendosur nga dispozita tranzitore në pikën 2 apo ajo që do të konkludohet më vonë në këtë vendim mbi njësimin e praktikës gjyqësore mbi çështjen e katërt dhe të pestë të shtruar për zgjidhje.

Nga ana tjetër pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, nën vijimin e logjikës kushtetuese të interpretimit të mësipërm, jep zgjidhje dhe mënyrë interpretimi ndryshe të ligjit. Transferimi i çështjeve nga prokuroritë e zakonshme në Prokurorinë e Posaçme, sipas listës së nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, nuk do të bëhet edhe për çështjet në hetim edhe për çështjet të dërguara tashmë për gjykim. Përkundrazi, pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, në këtë pjesë do të duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe literale *(stricto sensu)*. Ky interpretim, ndryshe nga ajo çka u zgjidh më lart, vjen pikërisht nga neni 148, pika 3, i Kushtetutës dhe nga pika ,2 e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ku parashikohet se çështjet që ndodhen për gjykim në gjykatat e zakonshme ditën e krijimit të GJKKKO-së dhe ato për të cilat mundet të vendoset rigjykimi, edhe pse veprat penale, objekt procedimi janë në listën e nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, do të gjykohen dhe përfundohen nga gjykatat e zakonshëm. Kjo do të thotë se parimi që kompetenca lëndore e gjykatës përcakton edhe kompetencën e prokurorisë që i atashohet asaj, dikton që në çështjet që ndodhen për gjykim përfaqësimi i akuzës në gjyq do të bëhet në gjykatat e zakonshme nga prokuroritë respektive të zakonshme, pavarësisht se veprat penale objekt procedimi futën në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se, për zbatimin kushtetues të pikës 5, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ditën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, prokuroritë me juridiksion të zakonshëm do të transferojnë te Prokuroria e Posaçme vetëm çështjet që janë në fazën e hetimit paraprak dhe veprat penale e të cilave parashikohet në listën e nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale.

43. Nga analiza e mësipërme Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën e parë të këtij vendimi njësues, konkretisht mbi përgjigjen e pyetjes së parë të shtruar më lart, për njësimin e praktikës gjyqësore. Për qëllimet e njësimit të praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendosi se:

Për të gjitha çështjet që rrjedhin nga hetimi apo gjykimi i veprave penale të listuara në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të

Procedurës Penale[9], procedimi i të cilave është regjistruar në prokurori apo në gjykatë para datës 1.8.2017, ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq do të jetë në kompetencën lëndore të prokurorisë për krimet e rënda.

Për të gjitha çështjet e tjera penale, procedimi i të cilave është regjistruar në prokurori apo në gjykatë para datës 1.8.2017, ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq do të jetë në kompetencën lëndore të prokurorive zakonshme.

Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet penale të listuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që janë në fazën e hetimit paraprak te prokuroritë e zakonshme, do të transferohen te Prokuroria e Posaçme. Për çështjet që prokuroritë e zakonshme ka kaluar në gjyq, përfaqësimi i akuzës në gjyq do të bëhet nga prokuroritë e zakonshme.

Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet penale të listuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që janë te prokuroritë e krimeve të rënda, pavarësisht fazës dhe gjendjes së procedimit, do të kalojnë nëpërmjet transferimit te Prokuroria e Posaçme.

Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, prokuroritë e krimeve të rënda do të kalojnë në prokuroritë e zakonshme të gjitha çështjet veprat penale objekt procedimi i të cilave nuk parashikohen në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, por që parashikoheshin në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale.

iv) Lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

b) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave me juridiksion posaçëm penal për kërkesat dhe çështjet e regjistruara për gjykim para datës 1.8.2017 dhe vazhdojnë të gjykohen pas kësaj date? Pra, cila gjykatë do të gjykojë çështjet që rrjedhin nga veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur para datës 1.8.2017?

44. Çështja e dytë e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore ka të bëjë me kompetencën lëndore gjyqësore të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm penal dhe atyre me juridiksion të posaçëm apo gjykatave për krimet e rënda, për veprat penale kërkesat për gjykim të të cilave janë paraqitur para datës 1.8.2017 dhe vendimet gjyqësore përfundimtare apo jopërfundimtare merren pas datës 1.8.2017. I gjithë debati dhe dilemat në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apeleve dhe vetë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka lindur pas hyrjes në fuqi të amendimeve të Kodit të Procedurës Penale. Më konkretisht, të gjitha këto dilema mbi atribuimin nga ligji të kompetencën lëndore gjyqësore i ka krijuar formulimi i pikës 1, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017.

Kjo pjesë e dispozitës parashikon, se: "*1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.*". Ndërkohë, për të njëjtën periudhë tranzitore, e njëjta dispozitë e rregullon ndryshe kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq, ndërmjet prokurorive të zakonshme dhe të posaçme. Pika 4, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, parashikon se: "*4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*".

45. Nga ana tjetër, neni 286 i ligjit nr. 35/2017, parashikon klauzolën e hyrjes në fuqi të amendimeve të Kodit të Procedurës Penale, duke

[9] Për qëllimet e kuptimit të drejtë të kësaj shprehje në të gjithë vendimin do të mbahet parasysh se sa herë që në vendim përmendet Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar do të kuptohen ndryshimet e ligjit nr. 35/2017. Më tej, sa herë që në vendim do të përmendet Kodi i Procedurës Penale, i pandryshuar, do të kuptohet Kodi i Procedurës Penale në gjendjen që ka qenë në fuqi para ndryshimeve të ligjit nr. 35/2017.

përcaktuar se ligji amendues hyn në fuqi në datën 1.8.2017. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se kërkesa për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për veprën penale objekt procedimi është paraqitur në gjykatë në datën **18.10.2016**, që do të thotë para datës 1.8.2017, në të cilën amendimet e Kodit të Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi. Kolegji Penal vëren se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 105, datë 19.12.2017, ka vendosur konstatimin e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ka prishur vendimin e kësaj të fundit, duke e dërguar çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda e ka ngritur kryesisht çështjen e kompetencës lëndore, me arsyetimin se: pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale (në datën 1 gusht 2017), Gjykata për Krime të Rënda nuk ka më kompetencë lëndore për të gjykuar veprën penale të "*Trafikimit të lëndës narkotike*" (neni 283/a, i Kodit Penal), por kompetenca u takon gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo do të thotë se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka konkluduar se nëse ligji procedural që atribuon kompetencën e gjykatës ndryshon gjatë gjykimit të një çështje, ai zbatohet menjëherë edhe mbi gjykimet e mbyllura më parë nga gjykatat, vendimi i të cilave nuk ka marrë formë të prerë, pasi është objekt ankimi.

46. Nga ana tjetër, Prokuroria në pretendimet e saj e interpreton këtë dispozitë, duke argumentuar se veprat penale, që do të jenë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pas krijimit të saj, aktualisht do të gjykohen nga gjykatat për krimet e rënda me atë grup veprash penale, të cilat edhe para ndryshimeve të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, me ligjin 35/2017, hynin në kompetencën e saj. Kurse, sipas organit të akuzës, gjykatat e zakonshme, do të kenë kompetencë mbi grupin tjetër të veprave penale, të cilat para ndryshimeve të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, hynin në kompetencën e tyre. Kjo nisur edhe nga leximi i pikës 4 të dispozitës tranzitore që përcakton kompetencën e prokurorive, pranë gjykatave për krimet e rënda. Ky konkluzion i organit të akuzës përfshin zgjidhjet e sugjeruara nga ato për secilën nga çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore në këtë gjykim.

47. Fakt është që dispozita tranzitore e Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1, nuk parashikon në mënyrë eksplicite se çfarë do të ndodhë me çështjet të cilat janë për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, vendimet që jepen nga kjo gjykatë para dhe për të cilat është ushtruar ankim dhe pritet të gjykohen në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, dhe çfarë do të ndodhë për çështjet që janë në gjykim pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, qoftë për apelet e paraqitura para datës 8.1.2017 dhe ato të paraqitura pas kësaj date. Duke lexuar menjëherë klauzolën e hyrjes në fuqi të amendimeve të Kodit të Procedurës Penale, duket sikur konkluzioni që nxirret nga leximi dhe zbatimi literal i dispozitës, është se: në datën 1.8.2017 gjykatat që humbin kompetencën lëndore, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, nuk mundet më të vazhdojnë të gjykojnë dhe të japin vendime edhe mbi çështjet e paraqitura para tyre më parë kësaj date.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në çështjen në shqyrtim, këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në disa gjykime dhe këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi. Por, ndryshe nga sa ka argumentuar dhe ka interpretuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka shkuar edhe më tej, duke e shtrirë rregullimin e nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale edhe mbi procedimet penale kërkesat për gjykim të të cilave janë paraqitur në gjykatë, para datës 1 gusht 2017, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të bëra me ligjin nr. 35/2017.

48. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se ky konkluzion dhe interpretim i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, që bën ndaj jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është i gabuar. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur asnjë qëndrim nëpërmjet të cilit i ka dhënë fuqi prapavepruese nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale edhe mbi gjykimet në shkallë të parë apo në apel të nisura apo të mbyllura para datës 1.8.2017. Përkundrazi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim jurisprudencial, se në një gjykim të nisur para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, pra

para datës 1.8.2017, ligji procedural që përcakton gjykatën kompetente apo kompozimin e trupit gjykues do të jetë ai që ka qenë në fuqi në momentin kur është paraqitur kërkesa për gjykim, pasi mosrespektimi i vazhdimësisë së gjykimit nga i njëjti trup gjykuese do të krijonte problematika të mëdha që do të ndikonin në gjykimin brenda një afati të arsyeshëm[10].

49. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë më parë, por pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të hyra në fuqi në datën 1 gusht 2017, ka mbajtur qëndrimin se nëse një vendim i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda prishet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çështja kthehet për rigjykim në e gjykatën e apelit me juridiksion penal të përgjithshëm, nëse vepra penale objekt procedimi nuk është në rrethin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale dhe e lidhur me ato vepra kompetencat lëndore të së cilave ushtrohen ekskluzivisht nga gjykata e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.[11] Në këtë mënyrë, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është interpretuar literalisht dhe e vetme, pika 1 e dispozitës tranzitore, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, sipas ligjit nr. 35/2017, jashtë kontekstit të nenit 148, pika 3 dhe nenit 178, pika 8 të Kushtetutës, nenit 57, të ligjit nr. 95/2017, nenit 36 të ligjit nr. 70/2017 dhe pikës 4 të nenit 285 të ligjit nr. 35/2017.

Më tej, Kolegji Penal, në dhomë këshillimi ka mbajtur qëndrimin, gjatë zgjidhjes së një parashtrese të ardhur për gjykim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës kundër një vendimi për shpallje moskompetence nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, se nga interpretimi literal i pikës 1, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, në kushtet kur nuk ka pjesën "*përpara hyrjes në fuqi të ligjit*", konkludon se ligjvënësi ka hequr nga kompetenca e mëparshme e gjykatës për krimet e rënda veprat që ajo gjykonte më parë, për të cilat do të shtrihet zbatimi i veprimit të juridiksionit të përgjithshëm nga gjykatat e rretheve. Kolegji Penal ka mbështetur këtë mënyrë interpretimi edhe në pikën 2 të po së njëjtës dispozitë tranzitore, duke u cituar shprehja e dispozitës se çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.

Kolegji Penal ka arsyetuar se nuk ka ndonjë kuptim juridik që veprat penale, që sipas nenit 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, kanë qenë në kompetencën lëndore të gjykatave për krimet e rënda, të liheshin nga ligji të gjykoheshin nga një gjykatë, ekzistenca e së cilës është në varësi të gjykatës me juridiksion të posaçëm dhe se një rregullim i tillë ligjor do të shkaktonte pasiguri dhe paqartësi, për sa kohë suprimimi i gjykatës për krimet e rënda do të krijonte pikëpyetje për vijimin e hetimit dhe gjykimit të veprave penale objekt procedimi, duke cenuar sakaq parimin e sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë së normës ligjore në ndarjen e kompetencave lëndore ndërmjet juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Kolegji Penal, në këtë vendim, ka dalluar kontrastin e formulimit të pikës 1 dhe 4, të dispozitës tranzitore të Kodit të Procedurës Penale, duke konkluduar se nuk mundet të përdoret si kriter për t'i dhënë gjykatës kompetencë lëndore, kompetenca lëndore e prokurorisë, por se anasjelltas është kriter, që do të thotë se prokuroria pranë një gjykate e merr vëllimin e kompetencave lëndore nga kompetenca lëndore e gjykatës. Me këtë vendim, si pasojë e këtij arsyetimi, është konkluduar se prokuroritë e rretheve gjyqësore do të ushtrojnë ndjekjen penale në hetim dhe në gjykim edhe për veprat penale, të cilat sipas nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, nuk janë më në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme[12].

50. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, megjithëse nga interpretimi literal i dispozitës tranzitore mundet të konkludohet, ashtu sikurse ka konkluduar Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, parimet kushtetuese dhe konventore të së drejtës për proces të rregullt ligjor, konkretisht në elementetin e *gjykatës së caktuar me ligj* dhe *gjyqtarit natyral të çështjes*, do të duhet të çonin gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit, në konkluzionin se *ndryshimet e mëvonshme të ligjit material apo procedural penal nuk mundet të afektojnë dhe të vënë në diskutim gjykatën e caktuar me ligj, juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore dhe kompozimin e trupit*

[10] Shiko vendimin nr. 00-2017-888, datë 5.10.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[11] Shiko vendimin nr. 00-2017-853 (130), datë 1.11.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[12] Shiko vendimin nr. 00-20180-140, datë 16.3.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

gjykues, çështje procedurale të cilat janë zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga ligji që ka qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim. Për rrjedhojë, Kolegji Penal konkludon se çështja e shtruar e dyta për efekte të njësimit të praktikës gjyqësore do të duhet të zgjidhet sipas rregullave të përgjithshme të veprimit të ligjit procedural në kohë për të përcaktuar gjykatën e caktuar me ligj dhe kompozimin e trupës gjykuese.

51. Kolegji vlerëson të nevojshme të sjellë në vëmendje rregullimet kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aktet që qëndrojnë në majën e piramidës normative kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. Neni 42 i Kushtetutës disponon se: "*1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*". Neni 6 i KEDNJ-së, nën titullin "*E drejta për një proces të rregullt",* ndër të tjera, disponon se: "*1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*".

52. Ndër elementet e procesit të rregullt ligjor, elementi që cenohet drejtpërdrejt nga kjo vendimmarrje dhe praktikë gjyqësore që ka mbajtur Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda është "*gjykata e caktuar me ligj*". Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, kompetenca e gjykatës është trajtuar si një ndër elementet përbërëse dhe thelbësorë të gjykatës së caktuar me ligj[13]. Në këtë kuptim, kur flitet për caktimin e gjykatës me ligj, ky standard implikon disa dimensione dhe aspekte. Fillimisht gjykata duhet të jetë konstituuar nga ligji; ligji të ketë caktuar mënyrën dhe momentin se si gjykata merr juridiksion dhe kompetencë dhe ligji të përcaktojë modalitetet se si kryhet, rast pas rasti, caktimi dhe kompozimi i trupit gjykues konkret. Kështu, mosrespektimi i këtyre rregullave passjell probleme serioze kushtetutshmërie. Kolegji vlerëson se parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenit 6 të KEDNJ-së, nuk mund t'i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen edhe gjyqtarit ose trupës gjykuese, e cila investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete apo gjyqtarit natyral të çështjes.

53. Kolegji Penal vlerëson se juridiksioni gjyqësor apo një ndër pushtetet ku bazohet sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, disiplinohet për t'u ushtruar në mënyrë të përditësuar nga gjykatat nëpërmjet kompetencës, e cila është njësi ligjore e juridiksionit gjyqësor. Kuptimi i kompetencës si kufi i ushtrimit të juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Kompetenca është një kusht dhe prezumim procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij, në kuptimin që një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është, ndër të tjera, parakusht për lë mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër *(ne bis in idem),* të parashikuar përkatësisht në nenet 4, pika 1 dhe 34, të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar[14].

54. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë elaboruar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete[15] dhe ky është rregulli i përgjithshëm, se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. Megjithëse, në të drejtën pozitive procedurale penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë, nuk parashikohet në mënyrë eksplicite

[13] Shiko vendimin nr. 23, 23.7.2009; vendimin nr. 7, datë. 9.3.2009; vendimin nr. 31, datë 1.12.2005; vendimin nr. 16, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

[14] Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 23.4.2009.

[15] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

parimi i gjyqtarit natyral të çështjes, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe, sidomos, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi ynë juridik një ndër elementet kryesore të gjykatës së caktuar me ligj ka standardin e gjyqtarit natyral[16], standard i cili është nga ana tjetër edhe e drejtë themelore e individit. *Ratio* e krijimit dhe e mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure autoritative shtetërore është te nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie i paanshëm përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm. Ky është një ndër premtimet kushtetuese që Republika e Shqipërisë, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, i ka bërë çdo subjekti të së drejtës.

55. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij, Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion apo jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji, me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe.

Nga kjo analizë konkludohet se ndryshimi i rregullave procedurale mbi përcaktimin e juridiksionit, kompetencës apo formësimit të gjyqtarit natyral të çështjes është përjashtim nga rregulla dhe jo rregull. Kjo do të thotë, se nëse Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji nuk ka rregullim tranzitor eksplicit për ndryshimin e juridiksionit, kompetencës apo gjyqtarit natyral për çështjet gjyqësore që gjen në gjykim, atëherë rregulla e përgjithshme, parim kushtetues dhe konventor i gjyqtarit natyral dhe i vazhdimësisë së juridiksionit dhe i kompetencës *(perpetuatio juridictionis et perpetuatio fori)* do të zbatohet natyrshëm në të gjitha këto gjykime.

56. Në këtë kuptim, doktrinat shkencore të së drejtës procedurale civile dhe penale evropiane kanë krijuar institutin *perpetuatio iuridictionis* dhe *perpetuatio fori*, për të konceptuar dhe regjuar juridikisht çështjet primare dhe fillestare, se si krijohet juridiksioni, kompetenca dhe gjyqtari natyral dhe se si ruhet permanenca dhe vazhdimësia e pandërprerë e kësaj figure gjyqësore garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të çdo subjekti të së drejtës, çështje të cilat nga ana tjetër janë edhe prezumimet procedurale kryesore dhe absolute të vlefshmërisë së procesit gjyqësor. Kjo do të thotë, se në momentin kur çështja regjistrohet në gjykatë, konkretisht për procesin civil dhe administrativ, kur padia paraqitet në gjykatë, sipas nenit 153 të Kodit të Procedurës Civile, dhe për procesin penal kur kërkesa për gjykim paraqitet në gjykatë, sipas neneve 331, 332/dh dhe 332/f të Kodit të Procedurës Penale, atëherë individualizohet edhe vëllimi i ligjit që rregullon gjykatën kompetente dhe mënyrën e formimit të trupit gjykues, qoftë trupa gjykuese e seancës paraprake dhe qoftë trupa gjykuese që do të gjykojë çështjen në themel. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë vlerëson se çdo ndryshim i mëvonshëm i faktit dhe i ligjit është irrelevant për të konkluduar mbi këto çështje procedurale. Pikërisht, nëpërmjet kësaj mënyre zbatohet neni 42 dhe neni 135 i Kushtetutës, duke individualizuar që në momentin, kur fakti ndodh gjykatën dhe gjyqtarin natyral të çështjes.

57. Ndërsa në Kodin e Procedurës Penale nuk ka një rregullim të tillë eksplicit, në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin nr. 49/2012, për gjykimin administrativ ka dispozita që e njohin në mënyrë eksplicite parimin kushtetues të *perpetuatio juridictionis* apo *perpetuatio fori*. Neni 36 paragrafi i pesë i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "*Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit.*". Neni 41, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se: "*Kompetenca përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit ose të ligjit.*". Këto dy dispozita zbatohen në mënyrë

[16] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

komplementare edhe në gjykimin administrativ, në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Edhe pika 1, e nenit 22, të Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: "*1. Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.*". Më tej, neni 23 i këtij ligji sanksionon se: "*1. Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi. 2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.*".

58. Nga kjo analizë krahasuese e legjislacionit procedural, Kolegji Penal konkludon mbi ekzistencën e një parimi procedural *jus cogens* mbi mënyrën se si individualizohet një autoritet shtetëror që ka juridiksion, kompetencë dhe se si formësohet nga ligji në kohë trupa gjykuese natyrale e çështjes për të ushtruar këtë pushtet të njohur nga ligji. Për rrjedhojë, Kolegji Penal vlerëson se e njëjta ligjësi vepron, edhe pse e pashkruar në mënyrë eksplicite në Kodin e Procedurës Penale, edhe në procesin penal në përgjithësi. Kjo do të thotë se ligji që përcakton juridiksionin, kompetencën dhe mënyrën se si individualizohet gjyqtari natyral i çështjes në procesin penal është ligji që është në fuqi kur paraqitet kërkesa për gjykim e prokurorit për gjykatën që do të zhvillojë aktivitetin procedural të seancës paraprake dhe vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq për gjykatën që do të gjykojë themelin e akuzës.

Kolegji mban parasysh se ka pasur edhe raste të tjera kur edhe kolegjet e thjeshta dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar dhe kanë vendosur mbi çështje të ngjashme të veprimit të ligjit procedural në kohë në të kaluarën. Përgjithësisht, kur janë krijuar gjykata me kompetenca të specializuara rishtazi[17] apo edhe kur kompetenca të caktuara me ligj kanë kaluar në lëndën e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm apo të posaçëm. Duhet të sillet në vëmendje, se rasti objekt njësimi është i ndryshëm nga rastet e mëparshme, pasi paraqet situatën juridike dhe faktike, kur gjatë periudhës së tranzicionit të prokurorive dhe të gjykatave për krimet e rënda

[17] Shiko, p.sh., vendimin unifikues nr. 1, datë 16.4.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili u mor për të zgjidhur çështjen se kush gjykatë do të ishte kompetente për të gjykuar veprat penale në kompetencën lëndore të gjykatave të sapokrijuara për krimet e rënda, kërkesat për gjykim të të cilave ishin paraqitur para krijimit të gjykatave të posaçme. Vendimi unifikues përcaktoi, se: "***Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda nuk mund të shqyrtojë në shkallë të dytë çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, para datës 1.1.2004, të cilat, sipas nenit 75/a të K. Pr. Penale, janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda ... Duke qenë dispozita me karakter të ndryshëm e me objekt rregullimi të ndryshëm, nuk bëhet fjalë për mospërputhje, kontradiktë apo ndeshje midis tyre, as për përparësi në zbatim. Ato plotësojnë njëra-tjetrën. Neni 14/3 i K. Pr. Penale është një dispozitë procedurale, që rregullon kompetencën lëndore, me karakter të përgjithshëm dhe me fuqi për të ardhmen (pas datës 1.1.2004), ndërsa neni 11/2 i ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003, si dispozitë kalimtare, ka karakter të përkohshëm dhe të kufizuar deri në përfundimin në shkallë të parë e në apel të çështjeve në proces gjykimi, para datës kur fillon zyrtarisht veprimtaria e gjykatave të krimeve të rënda.***". Shiko vendimin nr. 3, datë 6.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i cili përcaktoi gjykatën kompetente për të shqyrtuar çështjet në kompetencën lëndore të gjykatës administrative, paditë, apelet dhe rekurset e të cilave ishin paraqitur për gjykim para datës 4.11.2013, ditë kur hyri në fuqi ligji nr. 49/2012, "*Për organizimin dhe për funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*". Në këtë vendim, ndër të tjera u unifikua praktika gjyqësore, se: "***Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 3.5.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7, të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.".*** Shiko vendimin nr. 3, datë 28.4.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjera, në këtë vendim, u mor në shqyrtim rregullimi i periudhës tranzitore të gjykimit të padive dhe kundërpadive civile dhe administrative të paraqitura para datës 4.11.2013. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u shprehën se: "Është e rëndësishme të theksohet se një interpretim i tillë kryhet për shkak të një situate kalimtare dhe të përkohshme, për një kategori të caktuar çështjesh, duke mbajtur parasysh parimin e sigurisë juridike, përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor në kuptim të nenit 6, të KEDNJ-së, si dhe parimin e pritshmërive të ligjshme të shtetasve. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë, se në lidhje me çështjet e përmendura më sipër gjykimi duhet të vazhdojë në të njëjtën gjykatë, pa u lidhur me ndryshimet e mëvonshme të kompetencës lëndore të gjykatës, në lidhje me disa prej kërkimeve në padi apo kundërpadi. Në vijim të kësaj analize, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin njësues, se: ***Çështjet në të cilat gjatë gjykimit është paraqitur një kundërpadi, e cila ka natyrë të ndryshme nga ajo e padisë (respektivisht administrative ose civile), në rast se kundërpadia është paraqitur në gjykatë para datës 4.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e padisë, si në gjykimin në shkallë të parë, gjykatë të apelit apo Gjykatë të Lartë. Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërkime, si të natyrës civile dhe administrative, kërkime të cilat janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjykata ku ato janë paraqitur.".***

deri në konstituimin e institucioneve të reja të posaçme të drejtësisë penale, nevojitet të rregullohet në mënyrë tranzitore dhe të përkohshme kompetenca lëndore e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe kompetenca lëndore e gjykatave.

Kolegji Penal mban parasysh se edhe vetë dispozita tranzitore, konkretisht neni 285 i ligjit nr. 35/2017, në rregullimin e pikës 2, ka mbajtur parasysh dhe është frymëzuar nga parimi i vazhdimësisë së juridiksionit, kompetencës dhe ruajtjes së figurës së gjyqtarit natyral të çështjes. Kjo pjesë e dispozitës parashikon, se: "*2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.*". Nga kjo normë kuptohet se krijimi i GJKKKO-së nuk do të passjellë cedimin e kompetencës lëndore të gjykatave me juridiksion të zakonshëm për hir të gjykatave të posaçme në mënyrë të menjëhershme. Përkundrazi, ligji ka parashikuar se gjykatat e zakonshme, edhe pas datës së krijimit të GJKKKO-së, do të vazhdojnë të mbajnë, të gjykojnë dhe të përfundojnë gjykimet e nisura para kësaj date. Për më tepër, ligji parashikon se edhe për të njëjtat çështje, për të cilat eventualisht mundet të vendoset prishja e vendimit dhe kthimi i çështjes për rigjykim, gjykata kompetente për rigjykimin do të jetë serish gjykata me juridiksion të zakonshëm, sipas shkallës respektive të gjykimit. Më këtë zgjidhje, ligji ka synuar të ruajë parimin kushtetues të *perpetuiatio juridictionis*, *perpetuatio fori* dhe të gjyqtarit natyral, në mënyrë që të respektohet e drejta e të gjykuarve për standardet e procesit të rregullt ligjor.

59. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se ligji që konstituon gjykatën dhe gjyqtarin natyral duhet të jetë detyrimisht abstrakt dhe i përgjithshëm dhe mbi të gjitha duhet të jetë paraekzistues në raport me paditë, kërkesat apo në përgjithësi çështjet gjyqësore që disiplinon. Edhe në vështrim të doktrinës shkencore dhe jurisprudenciale evropiane të së drejtës procedurale civile dhe penale juridiksioni dhe çdolloj kompetence apo rregullat e kompozimit dhe të përcaktimit të trupit gjykues dhe të gjyqtarit natyral të çështjes janë të lidhura ngushtë me teorinë e *tempus regit actum*, pra me momentin kur nis gjykimi i çështjes, duke synuar sakaq të krijohet një barrierë e pakalueshme për tendencat e kujtdo individi apo pushteti rreth spostimit faktik apo ligjor të gjykatës dhe gjyqtarit të caktuar me ligj, duke mbrojtur sakaq gjyqtarin natyral të çështjes dhe permanencën e juridiksionit dhe të kompetencës së gjykatës gjatë gjithë fazave dhe shkallëve të gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon se në momentin kur një gjykatë ka fituar juridiksion, kompetencë sipas ligjit për një çështje apo për disa të tilla dhe në momentin kur një trup gjykues është konturuar sipas ligjit si gjyqtari natyral i çështjes, nuk mundet kurrsesi as edhe ligji i mëvonshëm material apo procedural *(ius superveniens)*, kur nuk ka dispozita tranzitore që parashikojnë ndryshe dhe kur gjykata e caktuar me ligj nuk është suprimuar, të ndikojë në nihilizimin e këtyre autoriteteve shtetërore gjyqësore garanci për të drejtat e njeriut, sipas parimit të gjithëpranuar në drejtat procedurale civile dhe penale evropiane mbi njëjtësinë dhe permanencën e trupës gjyqësore që titullohet e tillë dhe asaj që duhet të përfundojë shqyrtimin e çështjes *(ubi semel acceptum iudicium, ibi finem accipere debet)*.

60. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se gjithçka u analizua dhe u konkludua më lart, nuk mundet të vlerësohet se pamundëson gjykatën për të verifikuar me kërkesë të palëve apo kryesisht, në çdo fazë apo shkallë gjykimi, nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor apo kompetencën lëndore të gjykatës. Sigurisht, rregulla procedurale është se gjykata, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi merr në shqyrtim edhe kryesisht *(suo moto)* çështjen nëse ka juridiksion apo kompetencë, qoftë edhe pa prapësimin apo kërkesën procedurale të palëve. Megjithatë, kjo rregull, që ka dashur të garantojë në çdo moment vlefshmërinë e procesit gjyqësor, nuk do të thotë se gjykata në këto rast shqyrton juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore në raport me ndryshimet e mëvonshme që ka pësuar *"fakti"* apo *"ligji"*. Përkundrazi, gjykata e çdo shkalle, në këto raste, shqyrton nëse në situatën faktike dhe juridike kur është regjistruar çështja në gjykatë, duke e individualizuar në këtë mënyrë ligjin material apo procedural të zbatueshëm dhe në bazë të këtij konkluzioni disponon sipas çdo eventualiteti me vendim mbi këto çështje. Kështu, në çdo rast hulumtimi dhe procesi vlerësues i gjykatës në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, që i paraprin vendimmarrjes së saj mbi juridiksionin

apo kompetencën lëndore, është një shqyrtim retrospektiv dhe jo i përditësuar, ku optika vlerësuese e gjyqtarit hidhet te momenti kur çështja për gjykim është regjistruar në gjykatë.

61. Gjithçka u analizua më lart nuk është respektuar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, në momentin e shqyrtimit të apelit të ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në mënyrën se si gjykata e apelit ka vendosur mbi vendimin objekt shqyrtimi rishikues. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda nuk ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe parimin e *perpetuatio juridictionis* apo *perpetuatio fori* dhe nuk ka zbatuar drejtë në këtë mënyrë ligjin procedural penal në kohë në pajtim me Kushtetutën dhe me KEDNJ.

62. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin sakaq në konkluzionin e zgjidhjes së çështjes së dytë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore në këtë vendim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi se:

Çështjet e paraqitura për gjykim para datës 1.8.2017 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, sipas kompetencës lëndore të listuar në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, sipas parimit kushtetues të vazhdimësisë së juridiksionit, kompetencës dhe gjyqtarit natyral të çështjes, do të vazhdojnë të gjykohen në këtë gjykatë edhe pas datës 1.8.2017, deri në momentin e krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

I njëjti rregull vlen edhe për çështjet në gjykim në gjykatat e zakonshme.

v) Lidhur me çështjen e tretë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

c) Si do të përcaktohet kompetenca lëndore ndërmjet prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm penal për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale për të cilat procedimi penal ka nisur pas datës 1.8.2017 deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme? Pra, cila prokurori do të ushtrojë ndjekjen penale dhe do të përfaqësojë akuzën në gjyq për veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur pas datës 1.8.2017?

63. Çështja për të cilën dispozita tranzitore e amendimeve të Kodit të Procedurës Penale nuk ngjall mëdyshje është pikërisht mënyra se si ligji atribuon kompetencën lëndore të prokurorive për krimet e rënda dhe prokurorive të zakonshme për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq gjatë fazës tranzitore e deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme. Pika 4 dhe pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017 parashikojnë se: "*4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit, të ndryshuar, me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. 5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.*".

Në të njëjtën mënyrë, pak a shumë, e rregullon kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, në periudhën tranzitore edhe pika 5, e nenit 57, të ligjit nr. 95/2016. Kjo pjesë e dispozitës parashikon se: "*5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar". Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.*".

64. Ndryshimi i këtyre dy dispozitave tranzitore është te fakti se pika 5, e nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, e shpërndan sipas ligjeve procedurale që ishin në fuqi para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, që do të thotë për veprat penale të nenit 75/a, të pandryshuar të Kodit të Procedurës Penale te prokuroritë e krimeve të rënda, për veprat penale që parashikonte neni 141, pika 1, e pandryshuar, e Kushtetutës te Prokuroria e Përgjithshme dhe për

veprat penale me karakter mbetës te prokuroritë e zakonshme. Ndërkohë, pika 4, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, heq ushtrimin e juridiksionit fillestar të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq nga Prokuroria e Përgjithshme, që parashikonte dispozita më lart, dhe e dërgon atë te prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe te prokuroritë e krimeve të rënda, sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se ligji i zbatueshëm nga data 1.8.2017, do të jetë parashikimi më i ri, sipas parimit kushtetues që ligji i mëvonshëm shfuqizon ligjin e mëparshëm *(lex posterior drogat priori).*

Kjo do të thotë se nga data 1.8.2017, të gjitha çështjet në hetim apo gjykim, që kanë si lëndë procedimi veprat penale të parashikuara nga neni 141, pika 1, e pandryshuar, e Kushtetutës, do të kalojnë nga Prokuroria e Përgjithshme në prokurorinë respektive kompetente pranë gjykatës së rrethit gjyqësor apo pranë prokuroritë për krimet e rënda sipas rastit. Prokuroritë e zakonshme do të vazhdojnë të ushtrojnë juridiksionin fillestar të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq edhe për të gjitha veprat penale që nuk parashikohen në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Ndërkohë, për të gjitha veprat penale të listuara në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, do ta ushtrojnë prokuroritë për krimet e rënda, respektivisht sipas shkallëve të gjykimit. Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet për veprat penale të listuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që ndodhen për ushtrimin e ndjekjes penale gjatë fazës së hetimit paraprak në prokuroritë e zakonshme apo në hetim dhe gjykim në prokuroritë për krimet e rënda, do të transferohen në Prokurorinë e Posaçme. Nga ky koment, të gjitha çështjet e tjera që janë te prokuroritë e krimeve të rënda, qoftë në hetim dhe qoftë në gjykim, do të kalojnë për hetim dhe gjykim te prokuroritë e zakonshme, sipas gjendjes, fazës dhe shkallës së procedimit.

65. Ndryshimi tjetër i këtyre dy rregullimeve ligjore është, se, ndryshe nga pika 5, e nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, e interpretuar sipas argumentimit juridik që u bë më lart këtij vendimi, për llogari të konkluzioneve njësuese të çështjes së parë të shtruar për njësim, ka rregulluar ndryshe transferimin e çështjeve në gjykim për përfaqësimin e akuzës në gjyq nga prokuroritë e zakonshme te Prokuroria e Posaçme, për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i ndryshuar i Kodit të Procedurës Penale, por të dërguara në gjyq para datës së krijimit të Prokurorisë së Posaçme. Nga interpretimi i realizuar më lart, në këtë vendim dhe nga konkluzionet e arritura në pjesën e parë njësuese të këtij vendimi, u konkluduar se prokuroritë e zakonshme do të transferojnë te Prokuroria e Posaçme vetëm procedimet penale të ndodhura në fazën e hetimit paraprak, veprat penale lëndë të cilave listohen në nenin 75/a, të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se, ndryshe nga pika 5, e nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, pika 5, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ka përcaktuar se për çështjet e dërguara për gjykim, para datës së krijimit të Prokurorisë së Posaçme, nga prokuroritë e zakonshme, përfaqësimi i akuzës në gjyq do të bëhet në çdo shkallë gjykimi nga prokuroritë me juridiksion të zakonshëm. Sintonia e këtyre dy parashikimeve tranzitore të ligjeve të ndryshme korrespondon me rregullimet e njëjta për transferimin e çështjeve edhe për hetimin dhe përfaqësimin e akuzës nga gjyq nga prokuroritë për krime të rënda te prokuroritë e zakonshme dhe Prokuroria e Posaçme dhe për transferimin e çështjeve në fazën e hetimit paraprak nga prokuroritë e zakonshme te Prokuroria e Posaçme.

66. Në këtë mënyrë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin në sentencën njësuese të çështjes së tretë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi, se:

Nga data 1.8.2017, të gjitha çështjet në hetim apo gjykim, që kanë si lëndë procedimi veprat penale të parashikuara nga neni 141, pika 1, e pandryshuar e Kushtetutës, do të kalojnë nga Prokuroria e Përgjithshme në prokurorinë respektive kompetente pranë gjykatës së rrethit gjyqësor apo në prokurorinë për krimet e rënda, sipas kompetencës lëndore të tyre.

Prokuroritë e zakonshme do të vazhdojnë të ushtrojnë juridiksionin fillestar të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në

gjyq, për të gjitha veprat penale që nuk parashikohen në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Për të gjitha veprat penale të listuara në nenin 75/a të pandryshuar të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale dhe për përfaqësimin e akuzës në gjyq, deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, do ta ushtrojnë prokuroritë për krimet e rënda, respektivisht sipas shkallëve të gjykimit.

Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet për veprat penale të listuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që ndodhen për ushtrimin e ndjekjes penale apo për përfaqësimin e akuzës në gjyq në prokuroritë për krimet e rënda, do të transferohen në Prokurorinë e Posaçme. Çështjet e tjera do të transferohen në prokuroritë e zakonshme, sipas gjendjes së procedimit.

Në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet për veprat penale të palistuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, por të listuara në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, që ndodhen në fazën e hetimit paraprak në prokuroritë e zakonshme, do të transferohen në Prokurorinë e Posaçme. Për çështjet të cilat janë dërguar për gjykim nga prokuroritë e zakonshme në gjykatat e zakonshme, para krijimit të Prokurorisë së Posaçme, përfaqësimi i akuzës në gjyq do të bëhet nga prokuroritë e zakonshme.

vi) Lidhur me çështjen e katërt të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

ç) Si do të atribuohet kompetenca lëndore ndërmjet gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm penal për kërkesat dhe çështjet që janë regjistruar dhe regjistrohen për gjykim pas datës 1.8.2017 deri në momentin kur të krijohet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar? Pra, cila gjykatë do të gjykojë çështjet që rrjedhin nga veprat penale procedimi penal i të cilave ka nisur dhe do të nisë pas datës 1.8.2017?

67. Kolegji konstaton se dispozita tranzitore e amendimeve të Kodit të Procedurës Penale përcakton ndryshe literalisht kompetencën lëndore të gjykatave për krimet e rënda dhe ndryshe kompetencën lëndore të prokurorive për krimet e rënda. Kështu, në rastin e kompetencës lëndore gjyqësore, Kodi i Procedurës Penale referon te neni 75/a i tij, i ndryshuar, ndërkohë në rastin e kompetencës lëndore të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokuroritë, Kodi i Procedurës Penale referon te neni 75/a, i pandryshuar. Paradoksi i këtij rregullimi ligjor nxjerr konkluzione të papranueshme për rendin juridik kushtetues, pasi del se për gjykatat, nenet 74 dhe 75/a, të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale, kanë hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, ndërkohë për prokuroritë del se nenet 74 dhe 75/a, formalisht të pandryshuara, do të jetë në fuqi deri sa të krijohet Prokuroria e Posaçme dhe do të jetë pikërisht kjo datë që do të shënojë hyrjen në fuqi të neneve 74 dhe 75/a, të ndryshuara formalisht, të Kodit të Procedurës Penale.

68. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë rregullimi nga ligji dhe për më tepër kjo mënyrë literale interpretimi e ligjit çon në konkluzione dhe hipoteza të papranueshme të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe më tej edhe të gjykimit të çështjeve nga gjykata. Kështu, del se prokuroria e krimeve të rënda do të përfaqësojë edhe akuzat penale, që janë në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale dhe që nuk janë në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të zakonshme të apelit. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit do të cenonte njëlloj nenin 148, të pandryshuar dhe të ndryshuar të Kushtetutës, pasi edhe para edhe pas ndryshimeve të Kushtetutës, prokuroria ka qenë dhe është konceptuar si një organ që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq pranë gjykatës respektive. Nga kjo rrjedh konkluzioni se prokuroria, e ngritur nga ligji pranë një gjykate të caktuar me ligj, do të ketë si vëllim kompetencash lëndore, pikërisht ato që ka gjykata që ajo i atashohet. Akoma më tej, konkluzioni që rrjedh nga kjo mënyrë e organizimit institucional dhe funksional të institucionit kushtetues të prokurorisë, konkludohet se nuk mundet që gjykata ta marrë kompetencën lëndore nga prokuroria që i atashohet asaj, porse e kundërta

është ajo që ka paraparë Kushtetuta dhe ligji, që do të thotë se kompetenca lëndore e gjykatës përcakton vëllimin e kompetencës lëndore edhe të prokurorisë.

Ndaj në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kjo mënyrë e interpretimit të pikave 1 dhe 4, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, është e papajtueshme me nenin 148, pika 3, të Kushtetutës, e cila parashikon se: "*3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.*". Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kjo mënyrë e interpretimit të pikave 1 dhe 4, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, është e papranueshme. Mbetet të konkludohet nëse një ndryshim i tillë i rregullimit tranzitor të kompetencës së gjykatës për krimet e rënda është i qëllimshëm nga ana e ligjvënësit apo është ometim i pakujdesshëm ligjor.

Kolegji Penal vlerëson të sjellë në vëmendje se këtë logjikë ka ndjekur legjislatori edhe në hartimin e pikës 5, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, kur ka përcaktuar, se për çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroritë e zakonshme në gjykatat e zakonshme para datës së krijimit të Prokurorisë së Posaçme, përfaqësimin e akuzës në gjyq do ta bëjë prokuroria e zakonshme, si në çdo shkallë gjykimit dhe si në rigjykimet eventuale. Nga ana tjetër, kjo pikë ka parashikuar se vetëm çështjet në hetim nga prokuroritë e zakonshme do t'i kalojnë nëpërmjet transferimit Prokurorisë së Posaçme, për veprat penale që listohen në neni 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Në të njëjtën kohë tranzitimi kompetencave të prokurorive për krimet e rënda për çështjet nën hetim dhe në gjykim nga këto te prokuroritë e zakonshme dhe Prokuroria e Posaçme është realizuar nga kjo pjesë e dispozitës tranzitore me të njëjtën logjikë kushtetuese të njëjtësisë dhe të ruajtjes së identitetit të kompetencës lëndore ndërmjet gjykatës së caktuar me ligj dhe prokurorisë respektive që i atashohet asaj.

69. Mbështetur në teknikat e interpretimit, Kolegji vlerëson se interpretimi literal i ligjit do të pranohet sa kohë, kuptimi që ky interpretim i jep ligjit, është në përputhje me burimet e së drejtës që qëndrojnë më lart se ligji në hierarki, siç janë Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në rast të kundërt Kolegji vlerëson se është në detyrën e çdo gjykate, për hir të garantimit të parimit të kushtetutshmërisë funksionale[18], që të kërkojë forma të tjera interpretimi, siç është interpretimi i zgjeruar i dispozitës, interpretimi me analogji apo interpretimi teleologjik, ku në çdo rast interpretimi i zgjedhur duhet të jetë ai që është i pajtueshëm me Kushtetutën[19]. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se në rastin konkret ekziston mundësia që neni 285, i ligjit nr. 35/2017, të interpretohet në mënyrë pajtuese me qëllimet e nenit 178, pika 8, të Kushtetutës, në mënyrë komplementare me nenin 57, pika 5, të ligjit nr. 95/2016, duke pasur parasysh si konvencion edhe parashikimet e shfuqizuara të pikave 6, 7 dhe 8 të kësaj dispozite dhe me rregullimet me analogji të nenit 36, të ligjit nr. 70/2017.

70. Duke pasur parasysh konkluzionet e arritura më lart, pas analizës së kronologjike të dispozitave kushtetuese dhe ligjore tranzitore mbi kompetencën lëndore të gjykatave krimeve të rënda, gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, prokurorive për krimet e rënda dhe prokurorive të zakonshme dhe duke pasur parasysh interpretimin pajtues me nenin 148, pika 3, dhe 178, pika 8, të Kushtetutës, Kolegji konkludon, se deri në krijimin e GJKKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, do të jetë në fuqi nenet 74 dhe 75/a, të pandryshuara formalisht, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë, se pika 1, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, ka ometuar në rregullimin ligjor të saj, duke mos pasur të njëjtin rregullim sikurse pika 4, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017. Nga krahasimi i pikës 1[20] me pikën 4[21] del se ndryshimi është se pika 4, më tepër pikës 1 ka togfjalëshin "*sipas kompetencës së përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*".

[18] Shiko vendimin nr. 29, datë 9.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese.

[19] Shiko vendimin nr. 12, datë 14.4.2010; vendimin nr. 30, datë 17.6.2010; vendimin nr. 7, datë 27.2.2013; vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 dhe vendimin nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

[20] Kjo pjesë e dispozitës parashikon, se: "*1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit, të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.*".

[21] Kjo pjesë e dispozitës parashikon, se: "*4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit, të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*".

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon se mosmbyllja e pikës 1, të nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, është një pakujdesi në hartimin e normës dhe mangësi në mënyrën se si është përdorur teknika legjislative për të normuar rregulla kaq të rëndësishme sikurse është veprimi i ligjit në kohë dhe regjimi juridik gjatë periudhës tranzitore. Megjithatë, Kolegji Penal vlerëson se këto keqformulime të pakujdesshme të ligjit nuk mundet dhe nuk duhet të determinojnë mënyrën kushtetuese të zbatimit të tij dhe të ushtrimit të pushtetit të dhënies së drejtësisë. Roli i gjykatave dhe posaçërisht roli i autoritetit më të lartë gjyqësor, Gjykatës së Lartë, në qartësimin e rregullave ligjore është misioni kushtetues i pushtetit gjyqësor dhe se është thelbësor për shtetin e së drejtës. Ndaj, Kolegji Penal konkludon se kompetenca lëndore gjyqësore e përgjithshme dhe e posaçme dhe kompetenca lëndore prokuroriale e përgjithshme dhe e posaçme mbi procedimet penale para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore dhe pas, deri në krijimin e gjykatave dhe prokurorisë, sipas nenit 135, pika 2 dhe 148, pika 4 të Kushtetutës, do të rregullohet sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara formalisht, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë, se nenet 74 dhe 75/a, të ndryshuara formalisht, të Kodit të Procedurës Penale, do të hyjë në fuqi ditën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme. Pikërisht, kjo ditë do të shënojë edhe fundin e gjykatave dhe të prokurorive për krimet e rënda dhe fundin e veprimit të ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003, "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda*".

71. Kjo mënyrë a pakujdesshme e hartimit të dispozitave tranzitore ka krijuar edhe një nevojë tjetër për interpretimin në mënyrë pajtuese me Kushtetutën të nenit 74, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë e ndryshuar dhe e hyrë në fuqi në datën 8.1.2018, parashikon se: "*1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.*". Intepretimi literal i nenit 285, pika 1, të ligjit nr. 35/2017, duke pasur parasysh se neni 74, i ndryshuar formalisht, i Kodit të Procedurës Penale, ka hyrë në fuqi pa rezerva ligjore tranzitore literale në datën 1.8.2017, do të çonte në konkluzionin formal se nga data 1.8.2017, veprat penale që janë në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale dhe që nuk janë në nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencën lëndore të gjykatave të rrethit gjyqësor, duke konkluduar se gjykatat e krimeve të rënda nuk kanë më kompetencë lëndore nga kjo datë për to. Teknika legjislative e duhur do të duhet të kishte parashikuar në mënyrë eksplicite edhe një parashikim tranzitor për hyrjen në fuqi të nenit 74, të ndryshuar formalisht, të Kodit të Procedurës Penale, dhe kjo nuk ka ndodhur në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sërish për arsye të pakujdesisë në formulimin e dispozitës tranzitore. Sërish Kolegji konkludon, se duke pasur parasysh interpretimin pajtues të realizuar më lart, do të konkludohet se neni 285 i ligjit nr. 35/2017, në pikat 1 dhe 4, në të vërtetë shtyn hyrjen në fuqi edhe të nenit 74, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, njëlloj sikurse neni vijues 75/a. Këto dy dispozita, në variantin e ndryshuar do të hyjnë në fuqi në fundin e periudhës tranzitore, konkretisht kur të shënohet konstituimi i GJKKKO-së.

72. Nga kjo mënyrë e interpretimit pajtues të dispozitës tranzitore me Kushtetutën kuptohet se për të gjitha kërkesat për gjykim që do të paraqiten pas datës 1.8.2017, do të jetë kompetente ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor ose Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda deri në momentin e krijimit të GJKKKO-së, respektivisht sipas parashikimeve të neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale. Pas krijimit të GJKKKO-së, për efekt të ligjit do të suprimohen Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe menjëherë do të shtrohet për zgjidhje fati i çështjeve që ato kanë për gjykim. Nga ana tjetër edhe gjykatat me kompetencë të përgjithshme në këtë datë do të kenë për gjykim çështje penale kompetenca lëndore e të cilave parashikohet të jetë e GJKKKO-së. Edhe për to do të shtrohet diskutimi nëse janë akoma gjykata kompetente apo jo.

Kolegji sjell në vëmendje se neni 285, i ligjit nr. 35/2017, e ka rregulluar këtë problematikë vetëm pjesërisht dhe se pjesa e parregulluar mbetet të zgjidhet jurisprudencialisht në këtë vendim njësues. Kështu, pika 2, e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, parashikon se: "*2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet*

për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.". Kjo dispozitë ka synuar të respektojë parimet kushtetuese *perpetuatio juridictionis*, *perpetuatio fori* dhe parimin e gjyqtarit natyral të çështjes për të gjitha çështjet që në ditën e krijimit të GJKKKO-së janë për gjykim para gjykatave që nuk suprimohen, pra para gjykatave me kompetencë lëndore të përgjithshme apo të zakonshme. Kjo do të thotë se gjykatat e zakonshme do të vazhdojnë të gjykojnë dhe do të përfundojnë gjykimet e nisura para datës së krijimit të GJKKKO-së, edhe pse për veprat penale, objekt gjykimi, neni 135, pika 2, e Kushtetutës, nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016 dhe neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se janë në kompetencë lëndore të GJKKKO-së. Kjo do të thotë se kompetenca lëndore e GJKKKO-së do të aktivizohet ekskluzivisht vetëm për çështjet që vijnë për gjykim pas datës së krijimit të saj dhe jo për çështjet që para kësaj date janë për gjykim në gjykatat e zakonshme.

E parregulluar nga dispozita tranzitore është fati i gjykatës së caktuar me ligj për të gjitha çështjet të cilat datën e krijimit të GJKKKO-së janë për gjykim në gjykatat për krimet e rënda. Duke pasur parasysh se çfarë është interpretuar më lart, mbi përjashtimin nga rregulla e zbatimit të parimeve kushtetuese të gjyqtarit natyral të çështjes, vazhdimësisë së juridiksionit dhe kompetencës në rastet e suprimimit të gjykatave, dhe duke pasur parasysh edhe parimin e përparësisë së kompetencës lëndore së posaçme mbi kompetencën lëndore të përgjithshme, Kolegji Penal vlerëson se të gjitha çështjet e varura për gjykim në gjykatat e krimeve të rënda ditën e suprimimit të tyre dhe ditën e krijimit të GJKKKO-së do të kalojnë për gjykim te këto të fundit, sipas shkallës së gjykimit, kuptohet kur kompetenca lëndore e të cilave futet në listën e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, të gjitha çështjet e tjera penale, që nuk përfshihen në këto dispozita të kompetencës lëndore të posaçme penale, do të kalojnë për gjykim nga gjykatat për krimet e rënda në gjykatat e zakonshme, sipas shkallës së gjykimit.

73. Sakaq, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën njësuese mbi çështjen e katërt të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi, se:

Të gjitha çështjet penale, që neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, i ka përcaktuar si kompetencë lëndore e gjykatave për krimet e rënda, të cilat do të paraqiten për gjykim pas datës 1.8.2017, do të vazhdojnë të gjykohen në këto gjykata, deri në datën e krijimit të gjykatave të posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Në datën e krijimit të gjykatave të posaçme, nëse nuk ka ligj që rregullon ndryshe, çështjet në gjykim para gjykatave të krimeve të rënda, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, do të kalojnë për kompetencë lëndore sipas shkallës së gjykimit në gjykatat e posaçme.

Të gjitha çështjet penale, që do të ndodhen për gjykim në gjykatat e krimeve të rënda, të cilat nuk janë në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ditën e krijimit të kësaj të fundit, nëse nuk ka ligj që rregullon ndryshe, do të kalojnë për kompetencë lëndore sipas shkallës së gjykimit në gjykatat e zakonshme.

Çështjet penale të tjera, të cilat nuk përfshihen në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale edhe ato të përfshira në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencën lëndore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apeleve me juridiksion të përgjithshëm penal, deri në datën e krijimit të gjykatave të posaçme. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, do të përfundohen nga këto të fundit.

vii) Lidhur me çështjen e pestë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore:

d) Kur gjykatat e apelit apo Gjykata e Lartë vendosin prishjen e vendimit objekt ankimi dhe kthejnë çështjen për rigjykim, cila do të jetë gjykata që do të rigjykojë çështjen nga pikëpamja e kompetencës lëndore, nga data 1.8.2017 e deri në momentin kur të krijohet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar?

74. Duke pasur parasysh konkluzionet e arritura në sentencat unifikuese të mësipërme, kryesisht në çështjen e dytë dhe të katërt të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionet se edhe zgjidhja e çështjes së pestë së shtruar për njësim duhet të jetë e njëjtë me dy konkluzionet e para, gjatë periudhës tranzitore dhe deri në krijimin e institucioneve të posaçme të sistemit të drejtësisë penale, sipas nenit 135, pika 2 dhe nenit 148, pika 4 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se nëse gjykatat me juridiksion rishikues prishin vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe vendosin të kthejnë çështjen për rigjykim, atëherë çështja do të kthehet për rigjykim në gjykatën që ka kompetencën lëndore respektive sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara formalisht, të Kodit të Procedurës Penale. Ky regjim juridik tranzitor i atribuimit të kompetencës lëndore do të vazhdojë deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës.

75. Mbetet të zgjidhet çështja se çfarë do të bëhet me gjykimet të cilat janë në proces në gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe rishikues në ditën e krijimit të GJKKKO-së dhe për to kompetencën lëndore në bazë të veprës apo të subjektit të veprës e kanë gjykatat e posaçme. Pra çështja që shtrohet për zgjidhje është, se, nëse për to vendoset prishja e vendimit dhe kthimi për rigjykim, në cilën gjykatë do të kthehet çështja për rigjykim, në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm apo në GJKKKO-në e sapokonstituuar? Dispozita tranzitore e ligjit nr. 35/2017, ka parashikuar një zgjidhje të posaçme për këtë çështje. Pika 2 e nenit 285, të ligjit nr. 35/2017, parashikon se: *"2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.".*

Kjo do të thotë, se edhe pse vepra penale objekt gjykimi bën pjesë në kompetencën lëndore të GJKKKO-së, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, nëse kërkesa për gjykim apo ankimi është paraqitur në gjykatat e zakonshme para datës së krijimit të GJKKKO-së, atëherë kompetente për të vazhduar gjykimin do të jetë gjykata me kompetencë lëndore të përgjithshme. Ky rregullim tranzitor kuptohet që është vendosur për të respektuar parimin e vazhdimësisë së juridiksionit dhe të kompetencës dhe parimin kushtetues të gjyqtarit natyral të çështjes. Sikurse është konkluduar më lart këtij vendimi, GJKKKO-ja do të marrë për gjykim vetëm çështjet të cilat vijnë nga gjykatat e krimeve të rënda për shkak të suprimimit të tyre. Kjo do të thotë se GJKKKO-ja do të ketë kompetencë lëndore për të gjykuar të gjitha akuzat penale të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme, pas datës së krijimit të tyre dhe çështjet penale të ardhura nga gjykatat e krimeve të rënda pas suprimimit të tyre. Gjithashtu, kjo do të thotë, se pas krijimit të GJKKKO-së, ajo do të ketë kompetencë lëndore për të rigjykuar të gjitha çështjet për të cilat nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, GJKKKO-së e Apelit apo nga Gjykata e Lartë është vendosur prishja e vendimit të GJKKKO-së dhe kthimi i çështjes për rigjykim, sipas kompetencës lëndore respektive.

Nga ana tjetër, mbetet për t'u zgjidhur çështja e përcaktimit të gjykatës që do të rigjykojë çështjen penale pas kthimit për rigjykim nga gjykatat e apelit me kompetencë lëndore të përgjithshme dhe nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Nën logjikën e konkluzioneve njësuese të arritura deri më tani, kuptohet se për të gjitha çështjet që gjykatat e zakonshme të apelit mundet të vendosin rigjykimin, si para datës së krijimit të GJKKKO-së dhe pas kësaj date, gjykata kompetente për rigjykimin do të jetë gjykata e zakonshme, edhe pse vepra penale objekt gjykimi përfshihet në listën e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale.

Nga ana tjetër, të gjitha çështjet për të cilat Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, para datës së krijimit të GJKKKO-së, vendos prishjen dhe kthimin për rigjykim do të dërgohen në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nëse gjatë kësaj kohe GJKKKO-ja krijohet kompetenca lëndore për çështjet që do të rigjykohen, do të zgjidhet sipas konkluzioneve njësuese të arritura në pikën e katër të këtij vendimi. Pas krijimit të GJKKKO-së kuptohet natyrshëm që Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda nuk mundet të gjykojë më dhe, për rrjedhojë, nuk mundet të prishë vendimet e shkallës së parë dhe nuk mundet të kthejë më çështjet për rigjykim, pasi çështjet objekt gjykimi do t'i kalojë për gjykim në GJKKKO të Apelit. Ndërkohë Gjykata e Lartë kur prish

vendimin e gjykatës së apelit dhe kthen çështjen për rigjykim, për të gjitha çështjet gjykimi i të cilave ka nisur para krijimit të GJKKKO-së, do të duhet të ketë parasysh se, për vendimet e gjykatave të zakonshme të apelit në çdo rast çështja do të dërgohet në po ato gjykata, pavarësisht nëse vepra penale është kompetencë lëndore e posaçme penale apo jo. Ndërkohë, kur objekt i vendimmarrjes për prishje nga Gjykata e Lartë janë vendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për çështjet të cilat kanë nisur gjykimin para krijimit të GJKKKO-së, kthimi për rigjykim do të bëhet ose në gjykatën e zakonshme të apelit ose në GJKKKO-në e Apelit, sipas lëndës respektive të përcaktuar më lart.

76. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon sakaq në sentencën njësuese mbi çështjen e pestë të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi, se:

Deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, gjykatat e zakonshme të apelit dhe Gjykata e Lartë, në rastin kur vendosin prishjen e vendimit objekt ankimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim, do ta kthejnë çështjen për rigjykim në gjykatën kompetente lëndore, sipas parashikimeve të neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale.

Pas krijimit të gjykatave të posaçme, çështjet për të cilat vendoset prishja e vendimeve të gjykatave me juridiksion të zakonshëm do të dërgohen për rigjykim në gjykatat e zakonshme.

Pas krijimit të gjykatave të posaçme, çështjet për të cilat vendoset prishja e vendimeve të gjykatave për krimet e rënda dhe që nuk janë në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, do të dërgohen për rigjykim në gjykatat e zakonshme.

Pas krijimit të gjykatave të posaçme, çështjet për të cilat vendoset prishja e vendimeve të gjykatave për krimet e rënda dhe që janë në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, do të dërgohen për rigjykim në gjykatat e posaçme.

viii) Lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi

77. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se kërkesa për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për veprën penale objekt procedimi, është paraqitur në gjykatë në datën **18.10.2016**, që do të thotë para datës 1.8.2017, në të cilën mendimet e Kodit të Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi. Kolegji Penal vëren se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 105, datë 19.12.2017, ka vendosur konstatimin e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda dhe ka prishur vendimin e kësaj të fundit, duke e dërguar çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

78. Gjithçka u analizua më lart nuk është respektuar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda në momentin e shqyrtimit të apelit të ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në mënyrën se si gjykata e apelit ka vendosur mbi vendimin objekt shqyrtimi rishikues. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda nuk ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe parimin e *perpetuatio juridictionis* apo *perpetuatio fori* dhe nuk ka zbatuar në mënyrë pajtuese me parimet kushtetuese dhe procesin e rregullt ligjor ligjin procedural në kohë.

79. Kolegji vlerëson se edhe pse ishte njoftuar rregullisht për datën e seancës në Gjykatë të Lartë, mbrojtësi i të pandehurit Gani Bushati dhe ky i pandehur nuk u paraqitën në gjykim dhe për këtë, nuk paraqiti ndonjë shkak të ligjshëm mbi mungesën e paraqitjes. Në këto rrethana, Kolegji vendosi deklarimin në mungesë mbrojtësit të të pandehurit dhe vijimin e gjykimit të rekursit të paraqitur nga ana e prokurorit.

80. Për sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i ushtruar nga Prokurori pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë është i drejtë dhe duhet pranuar. Vendimi nr. 105, datë 19.12.2017, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, që ka vendosur konstatimin e moskompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ka prishur vendimin e kësaj të fundit, duke e dërguar çështjen në gjykatën kompetente të Rrethit Gjyqësor Durrës, është rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit. Ky vendim duhet të prishet dhe çështja të kthehet në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenit 441/1, shkronja "c", të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI :

Prishjen e vendimit nr. 105, datë 19.12.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

Ky vendim është njësues për praktikën gjyqësore.

Tiranë, më 4.4.2018

Anëtarë: Xhezair Zaganjori (kryesues), Shkëlzen Selimi, Edmond Islamaj, Artan Zeneli, Tom Ndreca

MENDIM PARALEL

Si anëtar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndonëse jam dakord me mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete objekt gjykimi, sipas dispozitivit të vendosur nga ana e shumicës së anëtarëve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, shpreh qëndrimin tim paralel mbi arsyetimin e vendimit dhe çështjet e shtruara për njësim, në raport me arsyetimin e parashtruar nga ana e shumicës, duke mos u pajtuar vetëm me mënyrën e njëjtësimit të çështjeve.

Çështjet e parashtruara për njësim nga ana e shumicës së Kolegjit Penal, i kapërcejnë tagrat për njësim që i janë njohur këtij Kolegji të Gjykatës së Lartë. Ato nuk mund të konsiderohen më si çështje për njësim, pasi në thelb, çështjet objekt njësimi duhet të konsideroheshin një tagër për ndryshimin e praktikës së Kolegjit Penal nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në bazë të nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Pushteti gjyqësor gëzon vetëm tagrin për të zgjidhur mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin dhe interpretimin e ligjit dhe jo tagrin për të krijuar të drejtë të re. Krijimi i normave të reja përbën një tagër kushtetues që i është njohur organit të Kuvendit, si përfaqësues i pushtetit ligjvënës.

Në rastin konkret, çështjet e ngritura dhe përgjigjet e dhëna për njësim nga ana e shumicës, i tejkalojnë kompetencat e këtij Kolegji për të interpretuar dhe për të zbatuar ligjin apo të për të zhvilluar atë. Praktika gjyqësore e krijuar më parë nga ana e Kolegjit Penal, ka rezultuar të jetë njësuar në lidhje me çështjet e ngritura për njësim nga ana e shumicës, prandaj çdo qëndrim ndryshe lidhur me këtë praktikë duhet konsideruar si ndryshim i kësaj praktike, i cili, rrjedhimisht, duhet të ishte bërë nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Shumica në arsyetimin e saj ka arritur në konkluzionin se për procedimet penale të regjistruara dhe për procedimet penale/çështjet në gjykim e sipër përpara datës **1 gusht 2017,** duhet të zbatohet ligji procedural, **përpara** ndryshimeve ligjore të bëra me ligjin nr. 35/2017 në Kodin e Procedurës Penale. Pavarësisht se shumica përmend frymën e rregullimit ligjor, ajo nuk e bazon këtë konkluzion ligjor në ndonjë dispozitë konkrete të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozita kalimtare në lidhje me procedimet penale të regjistruara në prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake apo çështjet penale të dërguara për gjykim në gjykatë, qofshin ato në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda apo të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, **përpara datës së hyrjes në fuqi** të ligjit nr. 35/2017, vetëm për shkak të parashikimit ligjor të shprehur do të vijojnë të gjykohen, përkatësisht në Gjykatën për Krime të Rënda apo në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor. Kësisoj, njësimi i arritur nga ana e shumicës në lidhje me çështjen "a" dhe çështjen "b" të objektit të njësimit, sa i takon kompetencës prokuroriale, **para datës 1.8.2017** dhe kompetencës së gjykatës për krime të rënda, është i qartë dhe i padiskutuar nga askush, derisa neni 285, i ligjit nr. 37/2017, akoma nuk kishte hyrë në fuqi.

Shumica ka arritur në konkluzionin, se pavarësisht që nenet 74 dhe 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, dhe ndryshimet ligjore të ligjit procedural penal kanë hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, sipas dispozitave tranzitore të vetë ligjit amendues dhe pikës 5, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, *për qëllimet e ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, kompetenca lëndore ndërmjet prokurorive pranë gjykatave për krimet e rënda dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit apo Prokurorisë së Përgjithshme,* ***do të përcaktohen sipas neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale.*** Kjo do të thotë se neni 75/a, i ndryshuar, i Kodit të Procedurës Penale do të hyjë në fuqi datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme. Të njëjtin fat do të ketë edhe neni 74, i ndryshuar, edhe formalisht i Kodit të Procedurës

Penale. Ky arsyetim i shumicës nuk na duket bindës dhe i mbështetur në ligjin procedural penal, për faktin se ligji nr. 35/2017, ka hyrë në fuqi në tërësinë e tij dhe nuk është parashikuar nga ana e ligjvënësit ndonjë kusht i shprehur për hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale, si kushti për krijimin e një gjykate apo ngritjen e një prokurorie. Ajo që dispozita kalimtare rregullon është kompetenca e gjykatës për krime të rënda deri në krijimin e gjykatës së juridiksionit të posaçëm, pra ky kusht nënkupton pikërisht, hyrjen në fuqi të ligjit procedural penal dhe rregullin e kompetencës së gjykatës dalëse me norma kalimtare deri në krijimin e gjykatës së juridiksionit të posaçëm. Çka do të thotë se nenet 74 dhe 75/a, të ndryshuara, të Kodit të Procedurës Penale, kanë hyrë plotësisht në fuqi me datën 1.8.2018 dhe përcaktimet e tij janë të detyrueshme për zbatim, si të gjitha dispozitat e tjera të ligjit nr. 35/2017.

Në lidhje me çështjen e dytë të parashtruar për njësim, ndaj mendimin se në të drejtën procedurale, ndryshe nga e drejta materiale, ligji i ri procedural ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim *(tempus regit actum),* me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe; pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale kalimtare që përcaktojnë një regjim ndryshe. Në këtë rast, në bazë të një interpretimi teleologjik të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 35/2017, arrihet në konkluzionin se ligjvënësi ka parashikuar në dispozitën e mësipërme transitore se Gjykata për Krime të Rënda vazhdon të ekzistojë dhe të gjykojë, respektivisht çështjet që ka në shqyrtim deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017. Kjo do të thotë se ka pasur një vullnet ndryshe të ligjvënësit dhe parimi *tempus regit actum* nuk është cenuar, ndaj dhe nuk ka pasur nevojë njësimi për të tilla çështje që vetë dispozita kalimtare ka zgjidhur.

Çka do të thotë, se në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës dhe, rrjedhimisht, edhe për procedimet e Prokurorisë për Krime të Rënda, për procedimet penale apo çështjet që janë regjistruar pranë Gjykatës për Krimet e Rënda deri datën 31.7.2017, duhet të gjejnë zbatim dispozitat që parashikonin ushtrimin e kompetencës, siç kanë qenë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale (data 1.8.2017, në bazë të ligjit 35/2017). Nisur nga përmbajtja e dispozitave kalimtare të parashikuara në pikat 1 dhe 4, të nenit 525, të Kodit të Procedurës Penale, për procedimet penale të regjistruara në Prokurorinë e Krimeve të Rënda brenda datës 31.7.2017, në çfarëdo faze dhe statusi qofshin ato, si edhe çështjet që janë dërguar në gjykim në Gjykatën për Krime të Rënda dhe që aktualisht janë në gjykim e sipër, në çdo fazë e në çdo shkallë të procesit; vlerësoj se vetëm për ato procedime dhe ato çështje penale duhet të vijojë të zbatohet parimi i vazhdimësisë së juridiksionit të gjykatave për krimet e rënda *(perpetuatio fori),* sipas kompetencës që ato kanë pasur më parë. Pavarësisht ndryshimeve ligjore të mëpasshme që kanë ndodhur në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda.

Megjithatë, nga analiza në tërësi e nenit 285, të Kodit të Procedurës Penale, ky përcaktim ka një kufi kohor **deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 35/2017, pra deri në datën 1 gusht 2017**. Çka do të thotë, se ndryshimet ligjore të hyra në fuqi do të zbatohen nga kjo datë e në të ardhmen për veprat e reja të ndodhura dhe të regjistruara nga kjo datë e në vijim. Shpreh qëndrimin se vetëm për procedimet penale të reja që janë regjistruar, duke filluar nga data 1.8.2017, hetimi dhe eventualisht gjykimi i çështjeve për veprat penale që nuk hyjnë më në fushën e kompetencës së parashikuar për Gjykatën për Krimet e Rënda (organ, i cili nuk parashikohet më në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale), do të hetohen nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykimi i tyre do të bëhet në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 525, të Kodit të Procedurës Penale, nga gjykatat e rretheve dhe jo nga gjykata e krimeve të rënda, e cila do të gjykojë vetëm ato vepra që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Nuk ndaj të njëjtin mendim me konkluzionin e arritur nga ana e shumicës mbi ekzistencën e një parimi procedural *jus cogens,* mbi mënyrën se si individualizohet një autoritet shtetëror që ka juridiksion, kompetencë dhe se si formësohet nga ligji në kohë trupa gjykuese natyrale e çështjes, i cili vepron, edhe pse e pashkruar në mënyrë eksplicite në Kodin e Procedurës Penale, edhe në procesin penal në përgjithësi. Po ashtu, nuk ndaj qëndrim të njëjtë dhe me konkluzionin se ligji që përcakton juridiksionin, kompetencën dhe mënyrën se si individualizohet gjyqtari natyral i çështjes në procesin penal është ligji që është në fuqi kur paraqitet kërkesa për gjykim e prokurorit për

gjykatën që do të zhvillojë aktivitetin procedural të seancës paraprake dhe vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq për gjykatën që do të gjykojë themelin e akuzës. Nëse ligjvënësi do të kishte dashur të parashikonte një efekt të tillë, ai do ta kishte parashikuar shprehimisht në dispozitat kalimtare. Parimi i përmendur si i zbatueshëm nga ana e shumicës nuk mund të supozohet se vepron në mënyrë të pashkruar, nëse nuk mund të bazohet në një normë procedurale të shkruar.

Përcaktimet ligjore për parashikimin e kësaj situate kalimtare janë vendosur nga neni 525, i Kodit të Procedurës Penale dhe për ato pjesë që nuk ka pasur parashikime ligjore të shprehura është më se evidente se do të gjejë zbatim parimi i përgjithshëm, i mirënjohur *tempus regit actum*. Pra, veprimi procedural do të rregullohet nga ligji kohës së kryerjes së tij në fushën procedurale. Në bazë të këtij parimi, duhet të zbatohet **e drejta procedurale** në fuqi, në kohën e shqyrtimit të kërkesës dhe të dhënies së vendimit. Kjo për faktin, se një norme e re procedurale ka hyrë në fuqi, kjo normë rregullon zhvillimin e gjykimit që nga çasti që ajo hyn në fuqi dhe se aktet procedurale të kryera gjatë normës së mëparshme do ta ruajnë fuqinë e tyre. Norma në fjalë do të zbatohet edhe për fakte të ndodhura më parë. Parimi vazhdimësisë së juridiksionit apo ai i vazhdimësisë së kompetencës *(perpetuatio juridictionis)* do të veprojë vetëm për vepra penale të kryera përpara se norma procedurale të ketë hyrë në fuqi, ndërsa për vepra penale të kryera pasi të ketë hyrë në fuqi norma procedurale e re, do të zbatohet kjo e fundit. Në të kundërt, norma e re procedurale nuk do të kishte mundësi të zbatohej asnjëherë.

Ky parim i përgjithshëm i së drejtës do të zbatohet në rastet e rregullave procedurale (pra, jo të atyre materiale), kur ligjvënësi ka çmuar të mos parashikojë një regjim ndryshe të situatës së kërkesave apo ankimeve gjatë kohës së ndërmjetme kur ka hyrë në fuqi ligji procedural, në raport me kohën kur është paraqitur kërkesa apo ankimi. Ky parim i përgjithshëm përbën një praktikë të mirënjohur dhe është konfirmuar edhe nga Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila e ka konsideruar të arsyeshme zbatimin e parimit të *tempus regit actum,* vetëm për sa u përket normave procedurale, në rastin *Scoppola 2 kundër Italisë*, vendimi Dh.M., datë 19.9.2009, § 110; rastin *Mione kundër Italisë*, nr. 7856/02, datë 12.2.2004; rastin e *Rasnik kundër Italisë*, nr. 45989/06, datë 10.7.2007; rastin *Martelli kundër Italisë*, nr. 20402/03, 12.4.2007.

Një praktikë e tillë është afirmuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e cila në vendimin e saj nr. 11, datë 23.4.2009, ka theksuar, se: "nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/ kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është 'e krijuar me ligj', sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane. Është parim i njohur e i pranuar, se ndryshe nga e drejta penale materiale, ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, **në të drejtën procedurale penale vepron parimi sipas të cilit, ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur se shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj**".

Në këto kushte, shpreh qëndrimin se konkluzioni i arritur nga ana e shumicës, sipas së cilës: *deri në krijimin e GJKKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, do të jenë në fuqi nenet 74 dhe 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, formalisht të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të mosparashikimit të rregullimit ligjor,* nuk është i mbështetur në ligj. Shumica në vendimin e saj, nëpërmjet këtij arsyetimi, ka shkuar përtej funksionit të zbatimit dhe të interpretimit të ligjit procedural, duke u shndërruar në ligjvënës. Hyrja në fuqi e një ligji, apo norme procedurale nuk mund të jetë e kushtëzuar me krijimin e një organi gjyqësor. Përkundrazi, ushtrimi i kompetencës gjyqësore, pasi të jetë krijuar me ligj organi gjyqësor mund të kushtëzohet me krijimin e gjykatës. Edhe sikur të merrej e mirëqenë, për një çast se nenet që parashikojnë kompetencën e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk kanë hyrë në fuqi, atëherë meqenëse do të zbatoheshin dispozitat e mëparshme procedurale nuk do të kishte qenë e nevojshme të njësohej praktika e njësuar më parë e Kolegjit Penal të Gjykatës së

Lartë. Kjo për shkak se do të mjaftonte të saktësohej se vijon të zbatohet ligji i mëparshëm dhe nuk kemi të bëjmë me çështjen e kompetencës midis gjykatave dhe e drejta e zbatueshme do të ishte e qartë.

Shpreh bindjen, se në rastin konkret gjen zbatim rregulla e aplikimit të menjëhershëm të normave të reja procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore për veprat penale dhe jo sikundër ka arsyetuar shumica. Shpreh bindjen, se edhe pse gjykata e juridiksionit të posaçëm nuk është krijuar ende, ndarja e kompetencave, sipas nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, qëndron dhe është në fuqi, pavarësisht konstituimit të gjykatës së juridiksionit të posaçëm. Për më tepër, po të ndiqej qëndrimi që ka mbajtur shumica, duke arsyetuar se nenet 74 dhe 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë dispozita që nuk kanë hyrë në fuqi ende dhe varen nga krijimi i kësaj gjykate, ky argumentim i tillë nuk është bërë për të gjitha nenet që përmendet Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe kjo mospërmendje do të shkaktojë paqartësi dhe pasiguri juridike, sa u përket neneve 13, 14, 80, 382/2/3, 424, 430/1, të Kodit të Procedurës Penale. Për shkak se këto dispozita procedurale janë të lidhura organikisht dhe në mënyrë logjike e të pandashme me kompetencën dhe krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Sa i takon parashtrimit të çështjeve për njësim, sipas shkronjave "c" dhe "ç", përfundimi i arritur nga ana e shumicës, sipas të cilit për të gjitha kërkesat për gjykim, që do të paraqiten pas datës 1.8.2017, do të jetë kompetente ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor ose Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda deri në momentin e krijimit të GJKKKO-së, respektivisht sipas parashikimeve të neneve 74 dhe 75/a, të pandryshuara, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se neni 285 i ligjit nr. 35/2017, në pikat 1 dhe 4, në të vërtetë *shtyn hyrjen në fuqi edhe të nenit 74, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, njëlloj sikurse neni vijues 75/a*, nuk është i mbështetur në ligji. Kjo, për faktin se rezulton i qartë dhe i paekuivoktë vullneti i ligjvënësit për hyrjen në fuqi të neneve 74 dhe 75/a, të ndryshuara, të Kodit të Procedurës Penale. Në të kundërt, ligjvënësi nuk kishte përse të caktonte një datë të posaçme për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017.

Ajo çka shumica duhet të merrte në shqyrtimin ishte çështja nëse ligji nr. 35/2017 ka hyrë në fuqi në tërësinë e tij, si dhe çështja nëse normat për të cilat diskutohet respektimi janë të natyrës procedurale apo jo.

Shpreh bindjen se ligjvënësi nga njëra anë, ka shfuqizuar kompetencën e Gjykatës për Krime të Rënda, të parashikuar më parë në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, nga ana tjetër ai ka parashikuar kompetencën për gjykimin e çështjeve që do të jenë në kompetencën e gjykatës së juridiksionit të posaçëm ende të pakrijuar, përkatësisht nga Gjykata për Krime të Rënda dhe nga Gjykata e Rretheve.

Mënyra e interpretimit e ndjekur nga ana e shumicës, jo vetëm që bie në kundërshtim me nenin 285, të ligjit nr. 35/2017, duke qenë se nuk parashikon shprehimisht kushtëzimin e hyrjes në fuqi të neneve 74 dhe 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, me krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por edhe se pse "rifuqizon dispozitën e parashikuar nga nenet 74 dhe 75/a të Kodit të Procedurës Penale në versionin e mëparshëm", duke e bërë datën 1.8.2017, si jorelevante dhe vazhdimin e normave të mëparshme procedurale për një periudhë kohe të gjatë, duke mos mbajtur parasysh risitë e shumta të sjella nga reforma ligjore e vitit 2017 në Kodin e Procedurës Penale.

Në këto kushte, me zgjatjen e kompetencave të Gjykatës për Krime të Rënda, veprimtaria e kësaj gjykate nuk është e lidhur dhe nuk mund të jetë e lidhur me datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017. Në të tilla rrethana, ndarja e çështjeve për njësim si para, ashtu edhe pas datës 1.8.2017, e parashtruar nga shumica, nuk ka asnjë rëndësi themelore për njësimin e çështjes. Shpreh bindjen se kriteri më i saktë për njësim do të ishte kompetenca e gjykatave të zakonshme deri në krijimin e gjykatës së juridiksionit të posaçëm, në raport me kompetencat e gjykatës për krime të rënda deri në krijimin gjykatës së juridiksionit të posaçëm dhe jo njësimi i praktikës së vazhduar me ligjin e mëparshëm procedural, në raport me ligjin e ri procedural që sipas shumicës ende nuk ka hyrë në fuqi.

Gjithashtu, shpreh bindjen, se përfundimi i arritur sipas pikës "ç", sipas të cilit: "*të gjitha*

çështjet penale, që neni 75/a, i pandryshuar, i Kodit të Procedurës Penale, i ka përcaktuar si kompetencë lëndore e gjykatave për krimet e rënda, të cilat do të paraqiten për gjykim pas datës 1.8.2017, do të vazhdojnë të gjykohen në këto gjykata, deri në datën e krijimit të gjykatave të posaçme sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Në datën e krijimit të gjykatave të posaçme, nëse nuk ka ligj që rregullon ndryshe, çështjet në gjykim para gjykatave të krimeve të rënda, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenit 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, do të kalojnë për kompetencë lëndore, sipas shkallës së gjykimit në gjykatat e posaçme. Të gjitha çështjet penale, që do të ndodhen për gjykim në gjykatat e krimeve të rënda, të cilat nuk janë në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ditën e krijimit të kësaj të fundit, nëse nuk ka ligj që rregullon ndryshe, do të kalojnë për kompetencë lëndore sipas shkallës së gjykimit në gjykatat e zakonshme. Çështjet penale të tjera, të cilat nuk përfshihen në nenin 75/a, të pandryshuar, të Kodit të Procedurës Penale edhe ato të përfshira në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a, të ndryshuar, të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencën lëndore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apeleve me juridiksion të përgjithshëm penal, deri në datën e krijimit të gjykatave të posaçme. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, do të përfundohen nga këto të fundit, bie në kundërshtim me parimin e vazhdimit të kompetencës së gjykatës që përcaktohet në çastin që ka qenë në fuqi, kur është paraqitur kërkesa për gjykim e përcaktuar në vetë arsyetimin e shumicës së Kolegjit Penal.

Anëtar: Artan Zeneli

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë